



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Masteri Shkencave në:

“ Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor”

Universiteti i Sporteve të Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Erleta Çelmeta (Mato)

Prof.As. Roland Çerepi

Dhjetor / 2024

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.askal.al

E-mail: info@askal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në “ Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Sporteve të Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”
4	Urdhri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr 544, datë 15.09.2022
5	Urdhri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024	20 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2023 – 2024 199 studentë; Viti akademik 2024 – 2025 219 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në kuadrin e akreditimit të programit të studimit ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor”, kërkuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti i Sporteve të Tiranës, është realizuar procesi respektiv i vlerësimit, duke u bazuar fillimisht në aktivitetet e realizuara, sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” i ofruar nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit si njësi përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST).

Ky program ka ardhur nga riorganizimi i programit MP. "Mësuesi në edukimin fizik e shëndetësor në arsimin parauniversitar", me UMAS nr. 544, datë 15.09.2022. Sipas këtij urdhri, veprimtaria akademike e këtij programi studimi fillon në vitin akademik 2022-2023. Sipas këtij urdhri, UST duhet të përmbushte rekomandimet e ekspertëve në lidhje me përmirësimin e emërimit dhe përmbajtjen e lëndës "Vlerësimi i të nxënit", para fillimit të vitit akademik 2022-2023 (pika 3 e urdhrit). Sipas konfirmimit nga IAL, përmes AMS, më datë 05.12.2022 programi ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit.

Programi u riorganizua në zbatim të ligjit Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 83, pika 2, që përcakton se studimet në ciklin master në fushën e mësuesisë duhet të jenë me 120 kredite. Programi i riorganizuar me 120 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademikë (4 semestra) u miratua nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Urdhër MAS Nr. 544, datë 15.09.2022

Programi i studimit, bazuar në VKM Nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM nr 879, datë 18.12.2019 dhe shtojcat e tij, respekton kriterin që 30%-40% e programit të jenë lëndë karakterizuese të disiplinës shkencore ose ndryshe 36-48 kredite të ofrojnë formim në profilin përkatës të mësuesisë të kryer në studimet paraardhëse (diplomë e integruar në mësuesi apo studime bachelor që mundësojnë studime të mëtejshme në mësuesi/edukim), sepse krahas formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik të domosdoshëm në një program masteri në mësuesi, mundëson që nëpërmjet lëndëve, si më poshtë:

Programi i studimit përmban:

- Module të formimit të përgjithshëm – 9 kredite;
- Module të formimit karakterizues- 68 kredite;
- Module të formimit ndërdisiplinor dhe integruese- 19 kredite;
- Module plotësuese - 12 kredite;

- Detyrime përmbyllëse – 12 kredite;

Lëndët specifike:

- Teknologjitë e reja në Edukim Fizik dhe Shëndet;
- Psikologji Zhvillimi;
- Metodatat e Kërkimit Shkencor;
- Modelet e mësimdhënies dhe të nxënës;
- Menaxhimi i klasës;
- Kurrikula dhe Arsimi gjithëpërfshirës;
- Praktikë profesionale pedagogjike;
- Edukim Fizik dhe Shëndet;
- Biologji;
- Shëndeti dhe gjendjet kritike në moshën shkollore;
- Metodikë e lojërave lëvizore;
- Organizim i Edukimit fizik dhe Sportit;
- Metodikë e Atletikës;
- Metodikë e Sporteve Atletike;
- Koncepti i Mirëqenie Fizike dhe Shëndetit;
- Kineziologji;
- Trainingu;
- Praktikë profesionale pedagogjike në Edukim Shëndetësor, etj;

Numri i studentëve sipas viteve është:

- Për vitin akademik 2022-2023 është 201 studentë;
- Për vitin akademik 2023-2024 është 196 studentë;
- Për vitin akademik 2024-2025 është 219 studentë;



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë, të përcaktuara me VKM nr.824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, për programin e studimit të ciklit të dytë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UST, për të realizuar takimet në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof. Dr. Erleta Çelmeta (Mato)** dhe **Prof.As Roland Çerepi**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, MP. Majlinda Demnerli

Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:

- Ligji nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”
- Urdhër i MASH nr. 81, datë 25.02.2013;
- VKM nr. 824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”;
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017;
- Rregullore e Sigurimit të Cilësisë, ASCAL;

Aktivitetet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

Analiza e të dhënave parësore. Të dhënat parësore janë ekstraktuar nga raporti i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit të ciklit të dytë “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor ” (2022)1 i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm, Statuti i UST, Rregullore e UST, Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (FShL), paketa e plotë e dokumentacionit të programit, programet lëndore, si dhe dokumentacione të tjera administrative, siç është dokumentacioni i personelit.

Analiza e të dhënave dytësore. Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion. Takimet sipas agjendës së paracaktuar dhe të dakordësuar nga të dy institucionet janë zhvilluar në datat 10 dhe 11 Dhjetor 2024. Gjatë këtyre takimeve, u zhvilluan bashkëbiseda të qëllimta dhe vëzhgime. Kështu, u realizuan biseda me Drejtuesin e Njësisë Qendrore; bisedë me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, bisedë me Përgjegjësen e Departamentit të edukimit dhe Shëndetit, bisedë me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, bisedë me stafin akademik të programit të studimit; bisedë me përfaqësues të

Sektorit të Burimeve Njerëzore, bisedë me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumni dhe Komunikimit; bisedë me përfaqësues të studentëve të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor"; bisedë me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë, si edhe bisedë me përfaqësues të Drejtorisë së kërkimit Shkencor dhe Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve. Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit që mbulon programin e studimit
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program
- Takim me studentë të këtij programi
- Takim me përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, dhe Zyrës së Sigurimit të Cilësisë së Studimeve Master
- Takim me koordinatoren e kërkimit shkencor në UST
- Takim me përfaqësues të Zyrës së ALUMNI dhe Karrierës dhe Zyrës së Shërbimeve Studentore
- Takim me grupin e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë
- Takim me Përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore
- Takim në Sekretarinë mësimore

Gjatë këtyre takimeve u zhvilluan biseda të qëllimta që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm. **Vëzhgimet në Institucion.** Në të dy ditët e vizitës në Institucion u mundësuan vizitat në auditorët mësimorë, Bibliotekën, mjediset e shërbimeve të studentëve etj. Vlen të theksohet se përgjatë gjithë procesit të vizitës, Institucioni kishte marrë të gjitha masat dhe tregoi disponibilitet shumë të lartë dhe cilësor, si në organizim ashtu dhe në bashkëpunim, për realizimin me sukses të të gjitha staveve të procesit, si edhe duke iu përgjigjur në kohë kërkesave të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti i Sporteve të Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 24.12.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 119/15 Prot, datë 24.12.2024. Universiteti i Sporteve të Tiranës përcjell në ASCAL më datë 26.12.2024, me anë të shkresës me Nr. 3946/2 Prot, datë 26.12.2024, "*Mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit*", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatorë të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” është një program që stimulon përgatitjen e specialistëve të edukimit në funksion të interesave kombëtare për një cilësi më të mirë të arsimit në të gjitha nivelet e shkollimit. Ky program synon që të ruajë dhe të konsolidojë vlerat akademike dhe Kulturore. <i>Ref.1. Ligji i Arsimit të Lartë (LAL)</i> <i>Ref.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (FSSL)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Duke nxitur zhvillimin e kompetencave profesionale, ky program studimi bën të mundur konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore në sistemin arsimor shqiptar përmes pasurimit të traditës me koncepte dhe aftësi bashkëkohore. Për të realizuar misionin e programit të studimit, departamenti është përpjekur ta hartojë atë duke gërshetuar njohuritë teorike dhe praktike, për të inkurajuar te studentët mendimin kritik dhe krijues, si dhe t’i ekspozojë ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e përvetësimit të kurrikulës me kompetenca dhe zhvillimin e aftësive fizike dhe shëndetësore nëpërmjet një modeli mësimdhënie dhe nxënie të fokusuar me studentin në qendër, te aftësimi praktik, duke u orientuar nga praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Ref. 6. Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor”</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe	Bazuar në qëllimet dhe misionin e “Universitetit të Sporteve, Tiranë” (UST), si dhe fushën e veprimtarisë mësimore, ky

<p>ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>program studimi është ofruar në përputhje me to dhe prezantohet si në strategjinë e zhvillimit, ashtu edhe në rregulloren e institucionit dhe Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit.</p> <p>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit nëpërmjet programit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor” synon krijimin e një mjedisi profesional e bashkëkohor për studentët, duke zhvilluar një kurrikul cilësore dhe duke punësuar një staf akademik profesionist, të aftë dhe të motivuar në përcjelljen e dijeve dhe përditësimin e studentëve me të rejat e fundit në kurrikulën me kompetenca, metodologjinë e përdorur për përvetësimin e kompetencave dhe aftësimin praktik, për të rritur shkallën e përvetësimit të aftësive fizike dhe shëndetësore</p> <p>Një vlerë e shtuar që ndihmon në konsolidimin e këtij programi, është krijimi i një mjedisi pune që kultivon integritetin individual dhe institucional në të gjitha aspektet. Një mjedis i tillë konstruktiv dhe i civilizuar ka ndikuar e ndikon në shkëmbimin e lirë të ideve, në lirinë akademike në hulumtim, në mësimdhënie dhe në terren. Realizimi me përgjegjshmëri dhe transparencë i këtyre vlerave pasurojnë dhe konsolidojnë programin e studimit.</p> <p><i>Ref. 50.Plani strategjik i UST</i></p> <p><i>Ref.2. Statuti i Universitetit të Sportit të Tiranës</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin fizik dhe Shëndetësor”</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Ky program i nivelit të dytë Master i shkencave në “Mësuesi në Edukimin Fizik e shëndetësor” i është nënshtruar sfondit të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar, duke tentuar të përmirësojë cilësinë e arsimit në funksion të tregut të punës dhe kërkesave gjithnjë në rritje të formimit të specialistëve të edukimit me kompetencat e nevojshme për punë dhe jetë.</p> <p>Qëllimi kryesor është diplomimi i profesionistëve të aftë në këtë fushë, ku i diplomuari në Programi Master i Shkencave (120 ECTS) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” me dy vite akademike ka mundësi punësimi si mësues dhe më gjerë në institucione arsimore parauniversitare publike dhe jopublike në: shkollat e arsimit bazë; shkolla të arsimit të mesëm të lartë; institucione arsimore të arsimit të lartë; institucione arsimore në</p>

Gueta



	<p>nivel qendror dhe lokal; institucione publike dhe jopublike që merren me edukim dhe trajnim; organizata jofitimprurëse që kanë në fokus edukimin e fëmijëve edhe me aftësi ndryshe; si dhe në aktivitete private.</p> <p><i>Ref. 2. Statuti i Universitetit të Sportit të Tiranës</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Universiteti i Sporteve të Tiranës ka një dokumentacion të pasur lidhur me vizionin dhe misionin e IAL (statutin, rregulloren, planin strategjik dhe materiale të tjera) edhe në funksion të përgatitjes së specialistëve në fushën e mësuesisë së edukimit fizik dhe shëndetësor duke synuar rritjen e cilësisë të këtij program studimi në mënyrë të vazhdueshme.</i></p> <p><i>Po ashtu Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit nëpërmjet rregulloreve, raporteve vjetore dhe punës për kërkimin shkencor përmbushin realizimin e këtij standardi, duke mundur plotësimin e kriterëve të mësipërme në mënyrë të plotë..</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Plani i zhvillimit strategjik i UST përcakton se “Misioni i UST është t’i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimimit, hulumtimit, inovacioneve ; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve, sigurimin e suksesit të studentëve në një mjedis global , ofrimin e shërbimeve akademike dhe zhvillimin e një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës” (karakteristikë kjo e zhvilluar gjerësisht në strategjinë e institucionit)</p> <p>Zbatimi i këtij plani strategjik gjen mbështetje të plotë në programet e të gjitha cikleve që ofrohen, ku përmes shtyllës akademike synohet kryerja me efikasitet i procesit të mësimdhënies, me qëllim pajisjen e studentëve me dije bashkëkohore në fushën e edukimit fizik dhe shëndetësor,</p>

Qeto



	<p>zhvillimit dhe formimit të studentëve , për t'u përgatitur për jetën dhe tregun e punës.</p> <p>Programet lëndore të masterit përfshijnë lëndë teorike që trajtojnë çështje të përgjithshme, të veçanta dhe bashkëkohore të arsimit të nxënësve/studentëve, por edhe aftësim praktik të tyre në lidhje me fiziologjinë, biologjinë, sportet, kinezologjinë, atletikën lëvizore apo mirëqenien fizike. Ky program trajton në mënyrë të veçantë edhe karakteristikat bazë të kurrikulës, përfshi edhe atë të fëmijëve me nevoja të veçanta. Krahas këtyre, paraqiten modele dhe praktika të mira, të cilat ndikojnë në konkretizimin e koncepteve dhe lehtësojnë procesin e nxënies.</p> <p>Pedagogët e këtij programi studimi janë 16, 100 % të brendshëm dhe me tituj akademikë, Profesorë dhe Profesorë të Asociuar dhe gradën doktor. Programi master u jap gatishmëri studentëve për të qenë përtej kulturës dhe traditës vendase, bashkëkohore në mësimdhënie dhe nxënie të fushës gjuhë dhe komunikim, që në këto momente duhet të jenë prioritet i politikave arsimore në vendin tonë.</p> <p><i>Ref. 4. Programi i Studimit Master i Shkencave në "Mësuesi më Edukimin Shëndetësor"</i></p> <p><i>Ref. 9. Burimet njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi Master i Shkencave (120 ECTS) në "Mësuesi në Edukim fizik e Shëndetësor" me dy vite akademike është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>Pas rishikimit të programit mund të pohojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kjo përputhshmëri evidentohet në të gjithë programet e tjera të studimit të ofruara nga departamenti. - Departamenti përkatës ka zbatuar me përpikëri direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane në lidhje me klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit. <p>Janë zbatuar kriteret e përmbushjes së standardeve evropiane të kualifikimit duke aplikuar në mbi 30 % të programit të studimit përmbajtjen e fushave pedagogji - psikologji të mësuesisë dhe 70 % atë të sporteve dhe shëndetit.</p>


	<p><i>Ref. 1. Ligji i Arsimit të Lartë</i></p> <p><i>Ref. 5. Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit</i></p> <p><i>Ref. 7. Plani mësimor i programit të studimit MEFSh</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi Master i Shkencave (120 ECTS) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” me dy vite akademike është konceptuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. Përputhja shihet në disa aspekte:</p> <ol style="list-style-type: none"> programi master është ndërtuar mbi synimet e programeve bachelor në “Edukim fizik” që ofrojnë universitete të ndryshme shqiptare, publike dhe jo publike, por dhe mbi studimet master në profile të ndryshme të mësuesisë që ofron në vend; plotëson synimin për të përgatitur specialistë të zotë për tregun e punës brenda vendit dhe në rajon; është konceptuar si një model që kombinon standardet akademike me aplikimet e botës reale të tregut të punës; është konceptuar si një model që kombinon mësimin me kërkimin; paraqet një ofertë akademike elastike që ndërtohet duke mbajtur parasysh kërkesat e tregut, aftësimin praktik dhe interesat e studentëve; i përgatit studentët për të kontribuar për një sistem arsimor të efektshëm dhe më të zhvilluar; ka të integruar dimensionin ndërkombëtar; <p><i>Ref. 7. Plan- Programi i Studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin Shëndetësor”</i></p> <p><i>Ref. 7. 1. Pasqyra analitike e programit të studimit</i></p> <p><i>Ref. 7. Plani mësimor i programit të studimit MEFSh</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohe nga institucionet partnere.</p>	<p>UST nuk ofron asnjë program studimi të ciklit të dytë master profesional jashtë profilit të tij. Ky program i Master-it Shkencor është brenda profilit dhe ekspertizës së njësisë bazë dhe njësisë kryesore ku ofrohet, sikurse u përmend edhe më lart, pra të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit ofron trajnime të vijueshme, që lidhen me personelin arsimor parauniversitar dhe</p>

<p>trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>atij të arsimit dhe formimit profesional, me drejtuesit e shkollave, por dhe me module të posaçme për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tyre, p.sh., moduli për vlerësimin në të nxënë apo module të tjera që lidhen me mësimdhënien, zbatimin e kurrikulës në shkollë dhe vlerësimin e nxënësve. Këto trajnime ofrohen dhe për studentë që kanë mbaruar studimet master në këtë IAL. Por edhe atyre që shprehin interes për ndjekjen e këtyre veprimtarive.</p> <p><i>Ref. 19. Riorganizimi i Qendrës së Trajnimeve dhe formimit të vazhduar (Vendim Senati 2019)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rezulton se Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, që është njësia përgjegjëse për zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor" ka përvojën, kapacitetet, si edhe burimet e duhura akademike për ofrimin e programit të studimit. Programi i Studimit është në përputhje me fushën e veprimtarisë së UST, si edhe në përputhje me fushën akademike të studimit të FSHL dhe të Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit që mbulon zhvillimin dhe mbarëvajtjen e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në "Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor" e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet kryesore rregullatorë të institucionit që janë Rregullorja e UST, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregullorja e</p>




<p>personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit, si edhe Rregullorja e Programit të studimit.</p> <p>Rregullorja e UST përcakton kriteret kryesore të funksionimit të universitetit në tërësi, duke treguar se institucioni e zhvillon veprimtarinë përmes zbatimit të vendimeve, urdhrave edhe udhëzimeve të veçanta. Kjo rregullore përcakton edhe disiplinimin e marrëdhënieve të organeve dhe autoriteteve drejtuese me njësitë përbërëse të tij. Rregullorja e UST përcakton se rregulloret e brendshme të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë miratohen nga Senati Akademik, ndërsa rregulloret e brendshme të funksionimit të strukturave ndihmëse akademike me karakter administrativ rregullohen përmes rregullores së njësisë kryesore.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes përcaktohet se subjekte të rregullores së fakultetit janë organet dhe autoritetet drejtuese të FSHL, personeli akademik dhe administrativ, këshillat, komisionet, studentët, si edhe bashkëpunëtorët e fakultetit. Gjithashtu, në rregulloren e fakultetit përcaktohet me detaje mënyra e rregullimit dhe e kontrollit të jetës së brendshme të karakterit akademik dhe administrativ të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, institucioni nxit bashkëpunimin midis personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, duke siguruar marrëdhënie efektive bashkëpunimi midis tyre në vazhdimësi.</p> <p><i>Ref. 3. Rregullore e UST</i></p> <p><i>Ref. 5. Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Rezulton se në kuadër të realizimit të objektivave të procesit mësimor e formues, UST ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi prej vitesh me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>UST ka përcaktuar dhe zhvillon një politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve që ofron. UST ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institute kërkimore dhe institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë institucione publike,</p>

	<p>qendra të shërbimit social, shkolla publike dhe jopublike, OJF etj. Universiteti organizon çdo vit akademik praktika në institucione të ndryshme me studentë të Programit Master i Shkencave(120 ECTS) në “Mësuesi në Edukim Fizike Shëndetësor”. Praktika mësimore ka për qëllim aftësimin e studentëve në punën konkrete në institucione, njohjen e tyre jo vetëm me kurikulën e zbatuar në shkollë, por edhe me kurrikulën e shkruar nga shkolla dhe kurrikulën e përvetësuar nga nxënësit. Por lista më e gjatë e UST përfshin marrëveshje bashkëpunimi me shumë vende evropiane si me Universitetin “G.D. Annunzio”, Ghieta – Pescara, Itali; Universitetin Lituanëz të Sportit; Akademinë Kombëtare të Sportit “Vasil Lievski”, Sofje- Bullgari; Universitetin e Edukimit Fizik “Jozef Pilulski” Varshavë, Poloni dhe mjaft institucione të tjera.</p> <p>Vetë UST është anëtare e rrjetit Evropian të Edukimit Sportiv, Këshillit ndërkombëtar të Shkencave Sportive dhe Edukimit Fizik, dhe Observatori Evropian i Sportit dhe Punësimit. Këto marrëveshje bashkëpunimi synojnë shkëmbimin e dijes dhe rinovimin e njohurive të përbashkëta, krijimin e një raporti të qëndrueshëm bashkëpunimi e shkëmbimi akademik, shkencor e kulturor dhe ngritjen e një sistemi bashkëpunimi që promovon dhe vlerat e të dy institucioneve</p> <p><i>Ref. 10. Marrëveshje me partnerët</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe</p>	<p>Për zhvillimin e praktikës profesionale për të gjithë studentët që ndjekin programet e studimit që zhvillohen nga UST, Fakultetet e ndryshme të këtij Universiteti, janë lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi, sipas të cilave përcaktohen modalitetet e kryerjes prej studentëve të praktikave profesionale pranë institucioneve arsimore parauniversitare publike dhe jopublike, si edhe të drejtat dhe detyrimet e të dyja palëve.</p> <p>Nisur nga specifika e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor”, konstatohet se këto marrëveshje janë të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale që lidhen me programin e studimit. Institucioni bashkëpunon edhe me institucione të tjera që nuk kanë marrëveshje të nënshkruara, por që kanë pranuar të presin studentë për zhvillimin e praktikave. Për sa i takon mobilitetit, pedagogë të Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetësor kanë zhvilluar mësimet dhe prezantime në</p>

<p>mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>universitete jashtë vendit, për një javë ose semestër në kuadër të projektit Erasmus +, gjithashtu, edhe pedagogë të huaj kanë zhvilluar disa module në programet e studimit master. Në periudhën e vizitës së Grupit të vlerësimit të Jashtëm 3 pedagogë italianë (në kuadër të programeve të tyre të doktoraturës) dhe studentë të tyre po zhvillonin stazhe dhe kërkime të tyre në fushën e Edukimit fizik dhe Shëndetësor. Mirëpo, duke qenë viti i tretë i zbatimit të këtij programi studimi nuk shihet të ketë pasur shkëmbime të studentëve në programin Erasmus+, por nga bisedat me pedagogë të masterit tregohet se është përparësi mobiliteti i studentëve në të ardhmen.</p> <p><i>Ref. 10. Marrëveshje me partnerët</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, si njësi bazë që mbulon edhe zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor", në fund të çdo viti akademik zhvillon analizën e punës vjetore të tij, në të cilën shqyrtohet edhe zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit. Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik, edhe Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes paraqet raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore, në të cilin përfshihet edhe veprimtaria vjetore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit. Në këto raporte, analizohet ecuria e cilësisë mësimore që vjen si rezultat i zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në lidhje me vitin akademik të përfunduar, së bashku me problematikat e implementimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit</p> <p><i>Ref. 15. Raporti i departamentit. Vlerësimi i programit të MEFSH</i></p> <p><i>Ref. 15.1. Raporti vjetor 2021-2022</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kuadri i përgjithshëm rregullator i UST, por edhe i Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit është i plotë dhe ekziston një ndarje e qartë e detyrave që duhet të kryejë çdo njësi dhe person akademik apo ndihmës i institucionit. Në funksion të zbatimit të programit të studimit, ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë brenda dhe jashtë vendit.</i></p> <p><i>Në përfundim të çdo viti akademik, nga njësia kryesore dhe njësi bazë, analizohet ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të</i></p>

	<i>bashkëpunimit në funksion të rritjes së cilësisë së formimit të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” është i organizuar në lëndë mësimore të cilat ndahen në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese, si edhe Punim diplome (detyrime përmbyllëse). Për t’u nënvizuar në këtë program studimi janë lëndët e aftësisimit praktik në pedagogji, përfshi edukimin fizik dhe shëndetësor, të cilat duke iu shtuar praktikave profesionale i japin programit vlera të karakterit problemzgjidhës dhe mendimit kritik. Përfundimi me sukses i Programit të Studimit parashikon dy vite akademike dhe në përfundim të tij studenti fiton 120 kredite ECTS.</p> <p>Programi Master i Shkencave (120 ECTS) në “Edukim Fizik e Shëndetësor” me dy vite akademike është bazuar në planin mësimor dhe programet lëndore të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Baza ligjore e Rregullores së programit të studimit është Ligji Nr. 80/2015 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në</p>

Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”; VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar.; Udhëzimi Nr.31 i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, datë 29.12.2017, kreu III, pika 1, akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe Statuti dhe Rregullorja e UST.

Mbështetur në Urdhrin e MAS nr 225, datë 07.05.2018 “Për përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë të institucioneve të arsimit të lartë” për ngritjen e grupeve të punës dhe zbatimin e drafteve të propozuara prej tyre, Departamenti i Edukimit dhe Shëndetiti nënshtroi studimin dhe rishikimin e programit të përgatitjes së mësuesve të edukimit fizik dhe shëndetësor gjatë viteve 2022- 2023 zhvillimit të një kurrkule të re në këtë degë dhe kalimit të ndryshimeve të supozuara të nevojshme në mbledhjet e senatit, për përmirësimin e programit të studimit “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” konform draftit të realizuar nga grupi i punës pranë kësaj Ministrie.

Ndryshimet kanë përfshinë drejtimit e mëposhtme:


- Futjen e lëndëve të reja si p.sh “Pedagogji dhe Psikologji” deri në masën 40 %;
- Sistemimin modular të disa lëndëve;
- Rishikimin dhe përfshirjen e disa lëndëve për t’i përshtatur ato me kontekstin evropian, p.sh Arsim gjithëpërfshirës, etj;

pavarësisht mbështetjes në draftin e MAS, GJV do të sugjeronte:

Rishikimi i programit mësimor, duke mbështetur fushën e pedagogji- psikologjisë me lëndë si “Psikologjia e Edukimit”, “Psikologjia e individit dhe grupit”, pasi në masën 90 % të kësaj fushe Psikologjia përfaqësohet vetëm me lëndën “Psikologji Zhvillimi” dhe e gjithë pjesa tjetër i përket pedagogjisë.

Tashmë njihet roli i psikologjisë në lidhje me sportet dhe shëndetin. Po kështu do të propozonim edhe futjen e një lënde si “Legjislacioni arsimor” që do t’i njihte mësuesit e ardhshëm me

Erab



	<p>të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e mësuesve, nxënësve dhe prindërve.</p> <p><i>Ref. 7. Plan - Programi mësimor i Masterit Shkencor "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor"</i></p> <p><i>Ref. 7. Plani mësimori programit të Studimit Master Shkencor në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor"</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor"</i></p> <p><i>Ref. 32. Raporti nga grupi qendror për lëndët e formimit psikopedagogjik të mësuesve</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit për ciklin e dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor" është i përqendruar në zhvillimin e një sërë kompetencash të veçanta në fushën e kërkimit shkencor dhe të menduarit kritik, fushë kjo mjaft e rëndësishme në momentet që po përjeton shkolla dhe shoqëria jonë. Ky program ka për qëllim ofrimin e njohurive të thelluara dhe aftësive të përparuar në fushën e studimit ose punësimit. Synimi kryesor është të përgatisë mësues me një gamë të gjerë të shprehive dhe aftësive që janë të nevojshme në ushtrimin e profesionit. Në këtë program, studentët përfitojnë kompetencat e kërkuara dhe kuptimin kritik të teorive dhe parimeve akademike në fushën e dijeve. Përveç kësaj, ata zhvillojnë aftësi që janë esenciale për zgjidhjen e problemeve komplekse arsimore. Me përqendrimin në një trajnim të thelluar akademik dhe profesional, ky program i siguron studentëve një bazë të fortë të dijeve dhe aftësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave.</p> <p>Programi i studimit është i organizuar dhe ofron një përmbajtje të tillë që studenti të marrë formimin e duhur konform rezultateve të të nxënës, njohurive teorike bazë të fushës së studimit dhe aftësim praktik, me qëllim punësimin ose kualifikimin e mëtejshëm të tij.</p> <p>Ndërthurja teori dhe praktikë është karakteristike e kurrikulës së këtij programi, të cilën studentët mund ta marrin nëpërmjet lëndëve të ndryshme që kurrikula ofron, e cila nga ana tjetër, jep edhe mundësi që të përditësohet në institucionet arsimore në funksion të zhvillimeve të reja kurrikulare dhe të metodologjisë, për t'i aplikuar ato në kushtet reale të shkollës.</p>

Guata



	<p><i>Programi është një “paketë” e plotë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - kurrikul, didaktikë, (e përfaqësuar nga një sërë metodikash si e lojërave lëvizore, e atletikës, e sporteve artistike, metodat e mësimdhënies, etj); - aftësim praktik, e paraqitur në mënyrë të tillë që jep njohuritë e avancuara për këtë fushë studimi; - Studentët mund të përfitojnë kompetencat e duhura për t’u përshtatur me situata dhe probleme të ndryshme, p.sh., në një klasë me përbërje heterogjene ku përfshihen edhe fëmijët me nevoja të veçanta dhe me stile të ndryshme të nxëni; <p><i>Programi mësimor i Masterit Shkencor “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor”</i></p> <p><i>Ref. 7. Plani mësimor i programit të Studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor”</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor”</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Plani mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” ka të përcaktuar ngarkesën e praktikës profesionale e cila vlerësohet me 9 kredite ose 180 orë mësimore gjithsej, nga të cilat 80 orë përkasin Praktikës së edukimit shëndetësor dhe vetëm 100 orë i përkasin praktikës pedagogjike.</p> <p>Studentët duhet të zhvillojnë praktikë në një ose disa institucione, ose në institucionin ku janë të punësuar.</p> <p>Programi i studimit parashikon ngarkesën me 12 kredite të tjera për punimin e diplomës.</p> <p>Diploma parashihet si punë e pavarur dhe krijuese individuale e studentit në formën e një projekti ose studimi të integruar, me kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të gjitha lëndëve në programin e studimit. Udhëheqësi shkencor luan një rol paraprak të rëndësishëm me udhëzimet dhe rekomandimet që jep. Tema e diplomës para mbrojtjes është vlerësuar nga një recensues shkencor, i caktuar nga Departamenti.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes</i></p>

	<p><i>Ref. 5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetësor</i></p> <p><i>Ref. 23. Rregullore mbi kryerjen e praktikës mësimore</i></p> <p><i>Ref. 31. Rregullore e Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Programi Master i Shkencave (120 ECTS) në “ Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” me dy vite akademike është pjesë e formimit të atyre studentëve që kanë studiuar bachelor në Shkencat e Lëvizjes. Ky program thëllon njohuritë profesionale dhe shkencor në fushën e edukimit fizik dhe shëndetësor.</p> <p>Kandidatët që regjistrohen në këtë program studimi duhet të kenë përfunduar studimet me kohë të plotë ose të pjesëshme në një nga programet e studimit të njëjta ose të ngjashme të ofruara nga institucionet publike dhe jopublike, sipas përcaktimeve ligjore në këtë kategori.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programi Master i Shkencave (120 ECTS) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” me dy vite akademike respekton kriterin 5, sepse ai ka mbi 25% lëndë të formimit psiko-pedagogjik dhe duke realizuar më së miri përgatitjen e mësuesve të fushës së edukimit fizik dhe shëndetësor me kompetencat e duhura profesionale. Në listën e lëndëve të formimit pedagogjik dhe psikologjik shihen të jenë përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Psikologji zhvillimi; • Kurrikula dhe Arsimi gjithëpërfshirës; • Vlerësimi i nxënësit; • Menaxhimi i klasës; • Metodot e kërkimit në edukim; <p>Shihet se mjaft lëndë janë shprehur brenda sistemit modular për të garantuar dijë më të gjera dhe më fleksible në rast ndryshimesh për përmirësim dhe pasurim kurrikule.</p> <p><i>Por siç e theksuam më lart, duhet riparë një vlerësim më i thellë i lëndëve të psikologjisë si:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Psikologji e edukimit; • Psikologji individuale dhe e grupit;

	<p><i>që do ta fuqizonin përgatitjen e mësuesit të ardhshëm në fusha që lidhen direkt me sportet dhe shëndetin.</i></p> <p><i>Po ashtu, do kërkohej që mësuesve të ardhshëm t'u jepeshin më shumë njohuri dhe aftësi zbatuese në lidhje me legjislacionin arsimor pasi kurrikula aktuale nuk parashikon lëndë ose module në lidhje me të.</i></p> <p><i>Ref. 7. Programi mësimor i Masterit Shkencor “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor”</i></p> <p><i>Ref.7. Plani mësimor i programit të Studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor”</i></p> <p><i>Ref. 32. Raport nga grupi qendror për lëndët e formimit të vazhduar psiko-pedagogjik të mësuesve</i></p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi Master i Shkencave (120 ECTS) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” është ndërtuar mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Ligji për Arsimin e Lartë, nr.80/2015, datë 22.07.2015 dhe VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Është program i ciklit të dytë të studimeve, realizohet me 120 kredite dhe ofrohet me kohë të plotë në katër semestra. Pranimi i kandidatit për regjistrim bëhet kur ky i fundit ka kryer studimet në një program studimi të ciklit të parë dhe plotëson kriteret e përcaktuara nga njësia bazë.</p> <p>Miratimi i tarifave bëhet mbi bazën e ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSh, pika 3/ ç , neni 3; pikat 28, 29 30 , neni 49, neni 83, neni 85 në Statusin dhe në rregulloren UST. Të gjitha vendimet për tarifën e regjistrimit merren nga vendimet e Senatit Akademik, UST dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.</p> <p><i>Ref. 3. Rregullore e UST</i></p> <p><i>Ref. 17. 1. Tarifat e studimit (Bordi administrativ); Vendim senati nr 75, datë 26.06, 2023</i></p>

<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave (120 ECTS) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” i referohet Kornizës së 7 të kualifikimit.</p> <p>UST lejon transferimin brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha të njëjta dhe të përafërta vetëm në fillim të vitit akademik. Njohja e lëndëve ose moduleve bëhet duke pasur parasysh kreditet e lëndës, programin e lëndës dhe notën e marrë. Lënda ose moduli ekuivalentohet kur ka emërtim të njëjtë ose të ngjashëm dhe ka mbi 70% të përmbajtjes të njëjtë me programin e studimit që zhvillohet ne UST.</p> <p>Si vit i regjistrimit të studentit i caktohet ai që përshtatet në funksion të krediteve të njohura dhe numrit të krediteve dhe lëndëve të munguara, të cilat duhet të plotësohen në programin e studimit ku ka aplikuar studentit.</p> <p><i>Ref. 1. Ligji i Arsimit të lartë</i> <i>Ref. 6. Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Mbështetur në VKM Nr.310, datë 11.5.2022, “Për specifikimet për mbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit”, janë realizuar kodifikimi i programit të studimit, si dhe kodifikimi i lëndëve të programit.</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi që UST ofron aktualisht, nuk është program studimi i përbashkët me institucione të tjera vendas ose të huaj.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” janë përcaktuar qartë në përputhje me</i></p>

Orest



	<p>legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kodifikimi i programit është bërë në përputhje me kërkesat ligjore. Programet lëndore tregojnë kodin e çdo lënde të veçantë.</p> <p>Rekomandohet një rishikim i programit për ta përmirësuar dhe pasuruar atë në dobi të mësuesve cilësorë të së ardhmes me lëndë si Psikologjia e Edukimit apo Njohuri për legjislacionin e Arsimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i Studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, (njësia bazë) në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes.</p> <p>Bazuar Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 02, datë 07.01.2022, UST është akredituar në nivel Institucional për 6 (gjashtë) vite akademike deri në 06/01/2028), duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni.</p> <p>Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes është organizuar në 3 njësi bazë si më poshtë plotëson kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi, sipas të cilit një Fakultet organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit; 2. Departamenti i Sporteve Individuale; 3. Departamenti i Sporteve Kolektive; <p>Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 44 pedagogë, nga të cilët 38 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5 kanë titullin “Profesorë”; - 14 kanë titullin “Profesor i Asociuar”;

Guest

- 9 kanë gradën Dr./PhD;
- 10 Asistent Lektorë me Msc;

dhe 6 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku:

- 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”;
- 1 ka gradën Dr./PhD;
- 4 Asistent Lektorë me Msc;

Njësia bazë, Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, për dy vite akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	3	-	2	-
Prof. Asoc	6	-	5	-
Dr./PhD	6	1	6	1
Msc	2	4	2	-
Totali	17	5	15	1

Konstatohet se numri i PAE është më se i mjaftueshëm për zhvillimin me sukses të programit të studimit. Gjithashtu, konstatohet se personeli akademik me kohë të plotë (PAE) që përgjigjet për mbarëvajtjen e zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në Master i Shkencave në “Edukim Fizik e Shëndetësor” mbulon 100 % të ngarkesës mësimore të këtij programi studimi.

Ref. 1. Ligji i IAL

Ref. 5. Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit

Ref. Marrëveshje me pedagogët e jashtëm

Ref.36. Struktura analitike e personelit akademik, personelit ndihmës akademik / administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike dhe klinike

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues, rezulton se Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit , si njësi përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit të Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” nuk angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, por e mbulon këtë veprimtari me burimet e brendshme.</p> <p>Për zhvillimin e praktikave profesionale janë ngarkuar disa anëtarë të stafit që mbulojnë koordinimin për programet e studimit që departamenti ofron. UST ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme shkollore dhe organizata të biznesit për zhvillimin e praktikave. Vetëm në praktikën laboratorike është një personel akademik ndihmës.</p> <p><i>Ref. 36. Struktura analitike e personelit akademik, personelit ndihmës akademik / administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike dhe klinike</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Rregullorja e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit përcakton se roli i Koordinatorit të programit të studimit është i detyrueshëm. Çdo departament ka nga një koordinator, i cili koordinon punën me praktikën, marrëdhëniet me përgjegjësin, pedagogët etj.</p> <p>Koordinatori emërohet nga rektori për çdo departament dhe detyrat e tij përcaktohen qartë në rregulloren e departamentit dhe në rregulloren e fakultetit. Nga vizita në institucion dhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues, si edhe nga ajo çfarë është paraqitur në RVB, rezulton se Koordinatori i Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Shëndetit është vetë Përgjegjësi i Departamentit, detyrat e të cilës janë specifikuar në Rregulloren e UST, FShL dhe DESH.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 5. Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit , si njësi bazë e caktuar për zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në" Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor"</i></p>


	<p><i>përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.</i></p> <p><i>E gjithë veprimtaria e departamentit për përbushjen e standardeve të kësaj fushe karakterizohet nga korrektesia dhe zbatimi faktik i ligjshmërisë në fushën e arsimit të lartë .</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit si njësi bazë ka dokumentacion të plotë për programin Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” duke filluar nga shkresa që autorizon hapjen e programit pas aplikimit. Si njësi bazë, ky departament disponon rregulloren e programit, plan-programin, të dhënat për stafin akademik, ngarkesën mësimore, numrin e studentëve të regjistruar, shërbimet që u jepen atyre, raporte të monitorimit të performancës, etj</p> <p>Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë dhënë të plota dhe me të gjitha detajet e duhura në këtë dokumentacion. Informacionet për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit gjenden të publikuara në faqen e UST.</p> <p>Çdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ ka akses të plotë jo vetëm tek Statuti dhe Rregullorja e institucionit, por edhe tek kurrikula e programeve të studimit, planet mësimore, programet lëndore, rregulloret e programeve të studimit, si edhe aktet e tjera rregullatorë të UST. Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e tij. Programet dhe materialet e leximit për secilën lëndë hidhen edhe në sistem.</p> <p>Informacionet më të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë në Master i Shkencave në “Mësuesi në</p>

B. Ceto




	<p>Edukim Fizik e Shëndetësor” gjenden në dokumentet kryesore rregullatorë të UST dhe të njësisë kryesore/bazë, që më poshtë renditen sipas shkallës hierarkike të tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e UST; • Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (FShL); • Rregullorja e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit; • Rregullorja e Programit të Studimit; <p>Përveç dokumenteve të mësipërme rregullatorë, të dhëna më të detajuara jepen edhe në planin mësimor të programit të studimit, kurrikulën, si edhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>Ref. 2. Rregullorja e UST ;</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (FShL)</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullorja e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit ;</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullorja e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Ref. 7. Plani mësimor i Programit të Studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor”</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” përmban në pjesën hyrëse, objektivat e programit të studimit dhe më pas në planin mësimor tregohet semestri kur zhvillohet lënda, struktura e lëndës, emri i lëndës, ngarkesa mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, kategorinë ku përfshihet lënda (A-E). Gjithashtu, plani mësimor përcakton edhe numrin e lejueshëm të krediteve për çdo lëndë, si edhe orët mësimore që zhvillohen në auditor dhe jashtë tij.</p> <p>Programi i studimit organizohet në lëndë dhe praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Të dhënat e programit përcaktohen në kurrikulën dhe rregulloren e programit të studimit. Programi Master i Shkencave (120 ECTS) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” me dy vite akademike është program i ciklit të dytë të studimeve me 4 semestra në dy vite akademike. Afati maksimal i studimeve është 4 vite akademike. Plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ. Veprimtaritë që përbëjnë planin mësimor ndahen në:</p>

Broto

Mus

	<ul style="list-style-type: none"> • mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime , laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe séanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor); • studim individual (studim punimesh, relacionesh dhe projektesh); • Përgatitje për provime, detyrime përmbyllëse dhe veprimtari të tjera si praktika profesionale), etj; <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref.5. Rregullore e Departamentit</i> <i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Ref. 7. Plani mësimor i masterit shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor”</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit përcakton rregullat që duhet të ndiqen nga studentët lidhur me kriteret e pranimit, transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve. Më me detaje, Rregullorja e programit të studimit parashikon kushte dhe kritere që duhet të plotësohen për t’u pranuar në programin e studimit në zërin “Pranimi i studentëve”.</p> <p>Procesi i transferimit të studimit dhe ekuivalentimit të lëndëve të zhvilluara në një IAL/ program të mëparshëm studimi parashikohet në rregulloren e FShL. Programi është i organizuar në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Shqyrtimi i dokumentacionit duke filluar nga rregullorja e Masterit Shkencor dhe deri tek sylabuset vërtetojnë një gjë të tillë. Studentët e interesuar mund të informohen mbi kriteret e përmendura më sipër edhe përmes informacionit të dhënë në faqen zyrtare të UST.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e</p>	<p>Dokumentacioni i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” përmban edhe programet lëndore (syllabuset), të cilat janë ndërtuar mbi bazën e të gjithë elementëve të kërkuar nga VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Në të gjitha syllabuset, të cilat janë hartuar sipas anekseve të VKM-së</p>

Grato



<p>laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>nr.41/2018, tregohet emri i lëndës, kodi i saj, pedagogu përgjegjës, ngarkesa, tipologjia e lëndës, viti akademik, lloji i lëndës, temat themelore, qëllimet dhe rezultatet e të nxënit, format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit, frekuentimi, si edhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. Për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet program i detajuar, i cili miratohet përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i departamentit. Programet lëndore hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe konkretisht ndërtohet nga titullari i lëndës.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi bëhet në konsultim dhe si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme apo udhëzimeve ministeriale. Programet lëndore përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të vitit akademik, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët.</p> <p>Ndryshimet që pedagogët bëjnë para fillimit të vitit akademik në masën 20 % (të lejuar nga LAL) dorëzohen në departament dhe bëhen pjesë e arkivit të institucionit.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i></p> <p><i>Ref. 5. Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjithë dokumentacioni i plotë rregullator i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik e shëndetësor" përmban gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin me sukses të programit të studimit të tillë si planin mësimor, ngarkesën mësimore, programet lëndore, si edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), Programi i Studimit i Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” pozicionohet në nivelin 7-1 të KSHK-së. Gjithashtu, në Rregulloren e programit të studimit përcaktohet se Masteri Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” synon një kualifikim më të thelluar teorik/praktik të studentëve</p> <p>Programi i studimit i pajis studentët me njohuri teorike dhe praktike që në përfundim të studimeve të punësohen në përputhje me kualifikimin e fituar ose kur janë në punë, të ushtrorjnë profesionin e mësuesit në institucionet arsimore parauniversitare apo në qendra të zhvillimit të fëmijës, apo qendra praktike trajnimi në një nivel të lartë profesional. Kurrikula e programit është e përditësuar në përshtatje të plotë me tregun e punës, në mënyrë që studentët që diplomohen, të jenë të përgatitur për këtë treg.</p> <p>Duke qenë Master Shkencor që i përgatit studentët direkt për profesionin që do zhvillojnë, i është kushtuar një kujdes i veçantë edhe praktikës profesionale që zhvillohet në shkollë, të vëzhguar nga udhëheqësi i praktikës dhe nga mentori i institucionit. Emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi.</p> <p>Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar me 120 kredite (30 kredite për semestër) dhe 3000 orë mësimore (1500 orë për vit akademik), shpërndarë në orë leksionesh dhe seminaresh brenda dhe jashtë auditorit, orë studimi individual, etj në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Është ligji nr 80, datë 17,09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe neni nr 83, pika 2 që përcakton se programet master të mësuesisë duhet të jenë me 120 kredite. I konceptuar në këtë mënyrë, përfundimi me sukses i programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në " Mësuesi në Edukim e shëndetësor" u jep</p>

	<p>të diplomuarve mundësinë për t'u përfshirë drejtpërdrejt në tregun e punës në ato pozicione që parashikon kuadri ligjor ekzistues për studentët që përfundojnë nivelin "Master Shkencor". UST është vazhdimisht e interesuar për ndërkombëtarizimin e programeve të saj në mënyrë që studentët e diplomuar në auditorët e saj të kenë mundësi të punojnë edhe jashtë kufijve. Praktika aktuale tregon se disa agjenci kanë mundësuar një formë ekuivalentimi të diplomave të UST.</p> <p><i>Ref. 6. Plani mësimor i programit të studimit;</i> <i>Ref. 23. Rregullore e praktikave profesionale;</i> <i>Ref. 21.2. Strategjia e Ndërkombëtarizimit;</i> <i>Ref. 10. Marrëveshje të ndryshme;</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave është bërë e studiuar për të motivuar thellimin në njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, si dhe për të lejuar dhe lehtësuar punësimin e studentëve, gjë që konfirmohet edhe nga përqindja e lartë e të regjistruarve të punësuar. Ngarkesat janë hartuar konform kërkesave ligjore, përkatëse për pedagogët dhe stafin akademik.</p> <p><i>Ref. 7. Programi i studimit;</i> <i>Ref. 7.1. Plani mësimor;</i> <i>Ref. 7. Programet lëndore;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e Programit Master Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor";</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi,</p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës mësimore për studentët në dy vite dhe 4 semestra, vlerësimi në 60 kredite për vit dhe 30 kredite për semestër dhe planifikimi i studiuar i orëve mësimore mundëson arritjen e objektivave të programit të studimit Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor" duke marrë kështu rezultatet e pritshme të të nxënimit dhe aftësimin profesional. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Ngarkesat mësimore të pedagogëve janë konform kërkesave ligjore</p>

kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	<p><i>Ref. 3. Rregullore e UST;</i> <i>Ref. 4. Rregullore e FShL;</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” është hartuar mbështetur në përvojat më të mira evropiane dhe vendase në fushën e mësuesisë, struktura, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë në fushën e mësimdhënies dhe nxënies është në përputhje me profilin e këtij programi master dhe i përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Për të mundësuar arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin në përfundim të studimeve, programi i studimit ofron një ndërthurje midis formimit teorik dhe praktik. Kurrikula e programit ka shumë ngjashmëri me programe të njëjta të kësaj fushe studimi që ofrohen nga universitetet publike dhe jopublike në rajon, gjë që i ndihmon studentët në transferimin e studimeve brenda vendit, por dhe në zhvillimin e mobiliteteve në kuadër të programit Erasmus+.</p> <p><i>Ref. 1. Ligji i Arsimit të lartë;</i> <i>Ref. 3. Rregullore e UST;</i> <i>Ref. 4. Rregullore e FShL;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e programit të studimit;</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me pedagogët e lëndëve shqyrtojnë programet lëndore me qëllim përditësimin e literaturës bazë dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Kërkesën për shtimin e titujve të rinj departamenti ia drejton përgjegjësit të bibliotekës me anë të një e-maili, në të cilin bëhet kërkesa për shtim titujsh në çdo fillim viti akademik. Literatura është paraqitur në çdo program lëndor krahas literaturës në bibliotekë dhe asaj online. Pas vizitës në institucion, por edhe pas takimit me stafin akademik që zhvillon programin e studimit dhe me studentët, u konstatua se literatura bazë dhe ajo ndihmëse është përshtatur/ndryshuar, duke marrë për bazë literaturën e viteve të fundit.</p> <p><i>Por në vizitën e bërë në bibliotekë u konstatua se ekziston një sasi e vogël titujsh në fushën e mësuesisë dhe lëndëve pedagogji</i></p>

	<p>psikologji. <u>Rekomandojmë</u> që të punohet më shumë në këtë aspekt.</p> <p>Ref. 3. Rregullore e UST;</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave bazohet në VKM-në nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe të Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit parashikohen aftësitë dhe kompetencat që do të përfitojnë studentët pas përfundimit me sukses të programit të studimit. Departamenti përpiqet dhe ka arritur të përditësojë lëndët dhe modulet në mënyrë të vazhdueshme, duke shtuar listën e literaturës së detyruar dhe ndihmëse, por në mënyrë personale nga çdo anëtar i departamentit për lëndën ku është inkuadruar dhe jo sa duhet në bibliotekën e institucionit, Pedagogët kanë pasur si prioritet të vetin furnizimin e tyre me literaturë të 5 viteve të fundit.</p> <p>Ref. 6. Rregullore e programit të studimit;</p> <p>Ref. Raporti për akreditimin e programit të nivelit të dytë Master shkencor në “Mësuesi në edukim Fizik dhe Shëndetësor”;</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesinë Edukim Fizik e Shëndetësor” krijon hapësirat e nevojshme për aftësi dhe kompetenca të thelluara profesionale në fushën e mësuesisë duke përgatitur vizionarë dhe operatorë të aftë në rritjen e cilësisë së arsimit. Të diplomuarit me këtë program studimi mund të punësohen si mësues në shkolla të arsimit bazë dhe të mesëm (gjimnaze dhe shkolla profesionale), por dhe në institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore të arsimit lidhur me zhvillimin dhe politikëbërjen arsimore në fushën e sporteve.</p> <p>Ref. 7. Programi dhe plani mësimor i Masterit shkencor “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor”</p> <p>Ref. 10. Marrëveshje me partnerët</p>

Konkluzione	<p><i>Përfundimi me sukses i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor" u mundëson studentëve që të vijojnë plotësimin e profilit të tyre akademik për në nivelet më të larta të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve niveli 8), apo u jep atyre mundësinë për t'u përfshirë drejtpërdrejt në tregun e punës.</i></p> <p><i>Programi i studimit ka një raport të kënaqshëm teori-praktikë dhe programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim fitimin e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Pas vizitës në institucion, por edhe pas takimit me pjesëtarë të strukturave drejtuese dhe personelin akademik të Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, rezulton se pranë UST funksionon një rrjet i suksesshëm i studentëve të cilët angazhohen së bashku me pedagogët dhe organizojnë takime periodike.</p> <p>Në këtë departament ushtron veprimtarinë Bordi i Karrierës me ish-studentët dhe personalitete në edukim, i cili ka si qëllim edhe përmirësimin e kurrikulave dhe programeve në funksion të integritetit të suksesshëm të studentëve në tregun e punës. Ky Bord synon të luajë rol domethënës për punësimin e studentëve të fushës së edukimit, që diplomohen dhe certifikohen në UST, në punësimin e tyre në Institucione arsimore publike dhe jopublike, në qendra të zhvillimit të fëmijëve, në qendra rekreacioni, OJF etj. Që në periudhën e ndjekjes së këtij programi studimi, 80 % e studentëve janë në marrëdhënie pune.</p> <p>Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti ka të zhvilluar kulturën e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit dhe këtë e ka dëshmuar me ndryshimet 20% në</p>

Q. Stafa

[Signature]

	<p>programet e tjera. Për programin në fjalë, duke qenë në proces zbatimi për akreditimin e parë, nuk janë bërë ndërhyrje, por janë ruajtur të dhëna të identifikuar që lidhen me përmirësimin e mëtejshëm të tij. Praktika e punës në këtë drejtim zhvillohet në bashkëpunim me NJZHKC në përfundim të vitit akademik kur realizohet një pyetësor me studentët, i cili synon të sigurojë informacione të përpunuara dhe reale për qasjet, perceptimet dhe qëndrimet e studentëve në atë se çfarë ata po studiojnë dhe përmirësimet që ata do të dëshironin të kishin .</p> <p>Këshilli i studentëve është një nga partnerët e pedagogëve në ndihmë të përmirësimit të cilësisë së Programit të studimit. Gjithashtu, departamenti harton në mënyrë periodike analizë tregu dhe Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit, ku analizon qasje dhe këndvështrime të tregut, institucioneve partnere, konkurrencës etj., me qëllim përmirësimin, adaptimin me tregun dhe zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit.</p> <p>Në kuadër të identifikimit të nevojave për përmirësim dhe për një kurrikul sa më të arrirë, departamenti bashkëpunon me partnerët e jashtëm, me të cilët ka marrëveshje partneriteti dhe realizon leksione të hapura me studentët, për orientimin në tregun e punës dhe zhvillimin e praktikës profesionale. Departamenti, gjithashtu, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm vijon me planin e shkëmbimeve të studentëve dhe pedagogëve në universitete të ndryshme nëpërmjet Erasmus + Qasjet e përfituara nga këto shkëmbime sjellin eksperiencë të reja në përmirësim të mësimdhënies dhe planeve mësimore apo lëndëve/moduleve.</p> <p><i>Ref. 1. Ligji i Arsimit të lartë</i> <i>Ref. 2.1, Plani strategjik i UST</i> <i>Ref. 5. Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit</i> <i>Ref. 24. Alumni</i> <i>Ref. 21.1. Rregullore e Këshillit Studentor</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar,</p>	<p>Siç është përmendur edhe në RVB, studentët kanë përfaqësuesin e tyre në komisione të ndryshme ku mund të shprehin mendimet e studentëve për përmirësimin e programeve të studimeve. Gjithashtu, në UST organizohet çdo vit një proces anketimi në të cilin merren mendimet e tyre në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. NJSBC po ashtu organizon me</p>

B. Veto



<p>për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>përfaqësuesit e studentëve fokus grupe për të tërhequr në mënyrë më cilësore mendimet e tyre për mbarëvajtjen e programit të studimit. Zyra e Karrierës dhe Alumni, drejtuesi i Njesisë Kryesore, drejtuesi i Njesisë Bazë dhe dekani kryejnë takime të vazhdueshme me studentët aktualë dhe ata të diplomuar, formale dhe joformale, lidhur me ecurinë e programit mësimor. Në këto takime shkëmbehen ide dhe bëhen propozime për funksionimin dhe përmirësimin e tij. Opinionet e studentëve vlerësohen në mënyrë të veçantë.</p> <p><i>Ref. 2.1/ 50. Plani strategjik i UST</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Ref. 37. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët</i></p> <p><i>Ref. 21. Alumni</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” është realizuar në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme, me qëllim kryesor përshtatjen e programeve lëndore në përputhje me planin strategjik të institucionit dhe me ndryshimet ligjore. Zyra e Karrierës dhe Alumni mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentët dhe diskuton me ta eksperiencat që ata sjellin si dhe zhvillojnë diskutime dhe propozime për përmirësimin e programeve në mënyrë periodike . Vetë UST ka marrëdhënie të vazhdueshme me partnerë të ndryshëm si shoqata, rrjete profesionistësh, urdhrat cilët kontribuojnë në përmirësimin e programit.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” është rezultati edhe i nevojës për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës për mësues të diplomuar me Master Shkencor.</p> <p><i>Ref. 50. Plani strategjik</i></p> <p><i>Ref. 5. Rregullorja e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit</i></p> <p><i>Ref. 10. Marrëveshjet me partnerët</i></p>

Konkluzione	<i>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, në rolin e njësisë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit, përshtat në vijimësi përmbajtjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës, duke qenë në konsultim të vazhdueshëm me aktorë të tjerë të interesuar si studentët, pedagogët dhe partnerë të tjerë të shoqërisë dhe komunitetit të dijes.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave (120 kredite) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” synon të krijojë te studentët kompetencë (njohuri, aftësi, qëndrime, vlera) si në nivelin teorik ashtu edhe në atë praktik, të cilat janë të domosdoshme për edukimin dhe mbështetjen e nxënësve në shkollat ku ata do të punojnë.</p> <p>Programi synon të përgatisë mësues të përkushtuar për të mësuar, edukuar dhe për të mbështetur fëmijët në shkollë, në mënyrë që të krijojë te ata kompetencat e duhura, konform kërkesave zyrtare të Kornizës Kurrikulare të arsimit, pasi pjesa më e madhe e këtyre studentëve në dalje punojnë si mësues të arsimit parauniversitar. (K-12) Programet lëndore të masterit përfshijnë lëndë teorike dhe praktike që mundësojnë një formim tërësor, teorik dhe praktik.</p> <p>Gjithashtu, programi synon të ofrojë ekspertizë bashkëkohore në fushën e kompetencave kyçe që duhet të ketë një mësues në fushën e mësimdhënies, fokusuar në hartimin dhe zbatimin e kurrikulës, teorinë e të nxënësve dhe modelet e mësimdhënies, menaxhimin e klasës dhe vlerësimi i të nxënësve. Objektivat e programit të studimit janë në rrjedhën e qëllimeve dhe objektivave të zhvillimit të UST dhe dy shtyllave kryesore të zhvillimit:</p>

	<p>1. Shtylla akademike, fokusuar në veprimtarinë akademike me anë të kombinimit të shërbimeve arsimore, online me ato të drejtpërdrejta;</p> <p>2. Shtylla e studentit në qendër, fokusuar në veprimtarinë studentore dhe komunitare.</p> <p>UST synon të shkojë drejt aftësimin të studentëve me teknikat moderne të mësimdhënies dhe formimit të kërkuesit shkencor për zgjidhjen e problemeve në fushat e edukimit fizik dhe shëndetit, të cilat nuk mundësohen nga programe të tjera profesionale.</p> <p><i>Ref. 50. Plani strategjik i UST</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Baza e të dhënave për kërkimin shkencor mundëson monitorimin në kohë reale të veprimtarisë kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe njësive të UST. si edhe rankimin vjetor të njësive, bazuar në këtë vlerësim.</p> <p>Sipas rregullores, organi më i lartë i kërkimit shkencor në UST është Këshilli i Kërkimit Shkencor. Gjithashtu, çdo departament cakton nga personeli akademik i tij një “Koordinator për kërkimin”. Gjatë vlerësimit të jashtëm, koordinatori i njësive bazë është personi kontakti që ndjek hedhjen e të dhënave në portalin universitar. Mbi bazën e të dhënave të kërkimit shkencor bëhen analiza në njësitë bazë dhe ato kryesore të UST.</p> <p>Këshilli i Kërkimit Shkencor, si institucion i vlerësimit të brendshëm të cilësisë së kërkimit shkencor bën, në prani të koordinatorëve të kërkimit të njësive bazë, vlerësimin e përvitshëm dhe rankimin e njësive të UST.</p> <p>UST garanton nëpërmjet NjSBC-së përfshirjen e studentëve në vlerësimin e pedagogëve që zhvillojnë mësim me ta. NjSBC-ja organizon online pyetësonin me studentët dhe është përgjegjëse për përpunimin e rezultateve. Ajo analizon besueshmërinë dhe gjeneron raportin individual për secilin anëtar të stafit. Këto raporte i përcjell te organet drejtuese të UST-s. Raportet transferohen te përgjegjësit e njësive bazë, të cilët i bëjnë të ditura te stafi akademik. Stafi akademik vihet në dijeni në mënyrë konfidenciale për vlerësimet e bëra nga studentët. Çdo anëtar i Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit përzgjedh fushën e vet të kërkimit mbështetur në lirinë akademike të tij, duke punuar në</p>

Buata

[Signature]

	<p>të shumtën e rasteve në grup. Këtë vit akademik , UST ka edhe Drejtorinë e Kërkimit Shkencor që duket se ka sjellë më shumë efektivitet në punën kërkuese të pedagogëve me studentët.</p> <p><i>Ref. Organizimi i sesioneve shkencore në Departament</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>UST dhe Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit nxit studentët të jenë pjesë e trajnimeve dhe e projekteve të ndryshme që organizon institucioni. Siç është përmendur edhe në RVB për periudhën e viteve të fundit, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit kanë organizuar së bashku me organizatat studentore disa konferenca dhe workshope, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kroaci, Maqedoni, etj.</p> <p>Çdo vit akademik studentët me punimet e tyre janë pjesë e konferencave të pedagogëve dhe ndërstudentore në universitete jashtë vendit në kuadër të projektit Erasmus+. Në kuadër të mobilitetit të studentëve të projektit Erasmus +, studentët janë dërguar në Spanjë për një javë ose një semestër të tërë.</p> <p><i>Ref. 22. Miratim projektsh shkencore (vendime senati dhe Bordit të Administrimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Pedagogët e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit dhe më gjerë mbështeten financiarisht nga Universiteti, duke marrë pjesë në konferenca Shkencore të organizuara nga UST pa pagesë. E gjithë veprimtaria kërkimore e deritanishme e pedagogëve dhe studentëve është mbështetur financiarisht nga UST.</p> <p>Edhe pse ka një mbështetje nga njësia bazë, <i>GVJ rekomandon që UST të parashikojë një rritje të buxhetit në "Fondin bazë për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë shkencore", "për kërkimin shkencor bazë", "për veprimtaritë shkencore" si edhe "për botime me faktor impakti".</i></p> <p><i>Ref. 22. Miratim projektsh shkencore (vendime senati dhe Bordit të Administrimit)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kërkimi shkencor në UST funksionon në bazë të Rregullores së mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit mbulon një pjesë të shpenzimeve për financimin e projekteve kërkimore-shkencore, si</i></p>

Gueto



	<p><i>edhe botimin e artikujve në revista të indeksuara apo me faktor impakti. Shuma vjetore që mbështet projektet kërkimore të Departamentit shkon në 1.700.000 dhe po aq parashikohet edhe mbështetja e pedagogëve dhe studentëve për pjesëmarrjen në konferenca shkencore.</i></p> <p><i>Rekomandohet që UST të parashikojë rritjen e buxhetit në "Fondin bazë për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë shkencore", "për kërkimin shkencor bazë", "për veprimtaritë shkencore" si edhe "për botime me faktor impakti" në funksion të Programit të Studimit Master i shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor , program ky i ri që kërkon mbështetje më të fortë se programet e tjera</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Nga bisedat e zhvilluara në Institucion, u konstatua se njësia përgjegjëse për këtë program ndërmerr një rol të rëndësishëm në mbështetjen e grupeve lëndore dhe është gjithmonë në përpjekje për të realizuar projekte inovative kërkimore-shkencore. Kjo njësi koordinon dhe inkurajon bashkëpunimin e ngushtë me strukturat kërkimore të tjera brenda dhe jashtë fakultetit, duke synuar realizimin e objektivave të përcaktuara në programin e studimit nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta të kërkimit shkencor. Grupi i pedagogëve dhe studentëve të Programit të Studimit Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor" deklaruan zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta, si: hartimin e strategjive, raportet, monitorimin dhe analizat, procedurat, vlerësime etj., dhe aktivitetet si konferenca dhe botime, evente, projekte dhe programe, partneritet ndërkombëtar dhe promovim.</p>

Gueto



	<i>Ref. 5. Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	<p>Personeli akademik dhe ai mbështetës nxiten të kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në fushën e arritjeve të objektivave përfshihen edhe studentët të cilët angazhohen në matje, por edhe në punë të veçanta si analiza, studime dhe projekte me karakter kërkimor, jo vetëm në universitet dhe brenda vendit, por edhe jashtë tij.</p> <p><i>Ref. 20. Miratim projekti shkencor ku janë përfshirë edhe studentët</i></p> <p><i>Organizimi i sesioneve shkencore në departament</i></p> <p><i>Ref. 44. Pjesëmarrje në Konferenca shkencore (Miratim Senati dhe Bordi Administrativ)</i></p>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “ Mësuesi në Edukim fizik e Shëndetësor” synon të sigurojë që studentët të jenë të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u bërë profesionistë të suksesshëm dhe për të përmbushur kërkesat e licencimit në fushën e tyre të specializimit.</p> <p>Personeli akademik i brendshëm dhe i ftuar ka realizuar leksione të hapura dhe seminare për zhvillime të reja të rëndësishme të edukimit fizik dhe shëndetit. Në këtë drejtim ai zhvillon aktivitete të veçanta në lidhjet e tij të ngushta me institucionet arsimore dhe OJF-të. UST ka zbatuar politikën e përfshirjes së lektorëve dhe kërkuesve shkencorë në faza të ndryshme të procesit mësimor si elementë të rëndësishëm për shkëmbimin e ideve dhe metodave të mësimdhënies. Të ftuarit kanë qenë nga shumë fusha dhe të mirënjohur për ekspertizën apo eksperiencën e tyre.</p> <p><i>Organizimi i sesioneve shkencore në departament</i></p> <p><i>Leksione të hapura</i></p>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<p>Sipas RVB, Programi i studimit Master i Shkencave (120 ECTS) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” qëndron në koherencë dhe ndjek zhvillimet e fundit kërkimore dhe shkencore rajonale dhe kombëtare. Institucioni UST duke pasur për qëllim të nxisë, mundësojë dhe të promovojë rëndësinë e kërkimit shkencor për Shqipërinë dhe Rajonin në fushën e sporteve ka</p>

	<p>ngritur edhe Drejtorinë e Kërkimit Shkencor. Kjo qendër shërben si organizëm që bashkëpunon ngushtësisht me departamentet, institutet dhe organizatat jofitimprurëse të themeluara nga institucioni dhe mundëson ndjekjen dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare në fushën e formimit të studentëve si konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>Ref. 1. Ligji i IAL</i> <i>Ref. 24. Alumni</i> <i>Ref. 50. Plani strategjik i UST</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Për sa i përket programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor”, njësia përgjegjëse ka një qasje të përgjegjshme dhe të përshtatshme ndaj rekomandimeve të nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale dhe rrjetet profesionale. Kjo njësi jo vetëm që i merr parasysh këto rekomandime, por gjithashtu i zbaton ato në zhvillimin e programit të studimit.</p> <p>UST zhvillon aktivitete me Bordin e Karrierës ku diskutohet për përmirësimin e programit të studimit, nevojat e tregut të punës. Në Departamentin e Edukimit dhe Shëndetit ushtron veprimtarinë Bordi i Karrierës. Qëllimi i formalizimit të këtij Bordi është përmirësimi i kurrikulave dhe programeve në funksion të integritit të suksesshëm të studentëve në tregun e punës. Bordi synon të luajë rol domethënës për punësimin e studentëve të fushës së edukimit, që diplomohen dhe certifikohen në UST, në punësimin e tyre në shkolla publike dhe jopublike, në institucione publike lokale dhe qendrore, në OJF, por dhe punësim privat. Studentët që do të diplomohen, pas zhvillimit të praktikës profesionale që menaxhohen nga ZVA-të, do të hyjnë në provimin për licencim.</p> <p><i>Ref. 1. Ligji i IAL</i> <i>Ref. 50. Plani strategjik i UST</i> <i>Ref. 38. Ligji “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”</i> <i>Ref. 10. Marrëveshjet me partnerët</i></p>

<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Programi i studimit “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” është në përputhje me aktet ligjore vendore dhe rekomandimet ndërkombëtare, duke përfshirë direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian. Këto përfshijnë, për shembull, "Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU" (Direktiva për Kualifikimet Profesionale, 2005/36/EU). Kjo lidhje me legjislacionin vendas dhe standardet ndërkombëtare tregon se programi i studimit është i përshtatshëm për të përgatitur profesionistë në përputhje me kërkesat aktuale të tregut të punës dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht për profesionet e rregulluara. Programi i studimit u krijon mundësi studentëve që dëshirojnë të futen në provim licencimi në përputhje me aktet ligjore për profesionet e rregulluara. Kriteret e pranimit të tyre janë të tilla që e mundësojnë fitimin e licencës për mësues.</p> <p><i>Ref. 50. Plani strategjik i UST</i></p> <p><i>Ref. 38. Ligji “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”</i></p>
--	--

<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor është një program bashkëkohor. Institucioni ka ngritur edhe drejtorinë e kërkimit Shkencor, e cila ka për qëllim të nxisë, mundësojë dhe të promovojë rëndësinë e kërkimit shkencor për Shqipërinë dhe Rajonin në fushën e sporteve. Kjo drejtori shërben si organizëm që bashkëpunon ngushtësisht me departamentet, institutet dhe organizatat jofitimprurëse të themeluara nga institucioni dhe mundëson ndjekjen dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Quoto



Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit përmes dokumenteve të ndryshme pedagogjike bën të njohura metodat e ndryshme të mësimdhënies si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - orë leksione; - orë seminare; - orë mësimi të integruara leksione me seminarët; - orë ushtrime; - orë laborator; - projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup; - provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; - formën e praktikës profesionale të zhvilluar në auditor; - formën e praktikës profesionale të zhvilluar në laboratorë dhe/ose institucione/kompani me të cilat Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit ka marrëveshje bashkëpunimi dhe/ose në ente publike/private të zgjedhura nga vetë studenti dhe të dakordësuara me pedagogun përkatës të praktikës; - çdo formë tjetër të miratuar nga njësia kryesore. <p>Nga takimet e zhvilluara në institucion, por edhe në bisedat me pedagogë dhe studentë, rezultoi se gjatë zhvillimit të mësimdhënies përdoren edhe mjete audio vizuale si laptop-e, video-projektorë, të cilët përdoren jo vetëm nga lektorët, por edhe nga studentët gjatë prezantimit të detyrave të kursit, punimeve në grup, apo edhe atyre individuale.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra,</p>	<p>Rezulton nga takimet e zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, se ka një prirje të përgjithshme për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies, duke përdorur edhe teknika të përvetësuara gjatë programeve të shkëmbimit me universitetet partnere jashtë vendit. Gjithashtu,</p>

<p>metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik synon zbatimin me sukses të metodave të mësimdhënies me në qendër studentin. Për shkak së metodat e reja të mësimdhënies nuk janë përfshirë në dokumentet rregullatorë të programit të studimit,</p> <p><i>Rekomandohet që përdorimi i metodave të reja të mësimdhënies dhe të të nxënit të përfshihet në Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, si edhe më gjerësisht në Rregulloren e Programit të Studimit.</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Ref. 19. Pjesëmarrje në sesione të organizuara nga Qendra e Trajnimit të Vazhduar</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në RVB dhe që lidhet me performancën e stafit akademik, kryesisht nisur nga mobiliteti i personelit akademik dhe nga përmbajtja e CV-ve të personelit akademik të paraqitura, konstatohet se personeli akademik bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e performancës individuale dhe të aftësive mësimdhënëse. Siç edhe përmendet në RVB, organizimi i konferencave dhe seminareve shkencore në partneritet me universitete homologe brenda dhe jashtë vendit, ka krijuar mundësi që personeli akademik të shkëmbejë përvojë, mendime dhe literaturë në fushat e tyre të ekspertizës.</p> <p>Institucioni ka mbështetur personelin akademik të përfitojë nga programet e vizitave dhe shkëmbimit të personelit me universitetet e huaja, për të shkëmbyer eksperiencë dhe për t'u njohur me zhvillimet e rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit. Institucioni ka mbështetur pjesëmarrjen në konferenca e takime kombëtare e rajonale, përfshirjen në studime e botime, si dhe projekte të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p>Sipas bisedave me pedagogët dhe studentët, departamenti zhvillon vëzhgime për përmirësimin e kompetencës didaktike nga ana e vetë pedagogëve bazuar në fushat e tyre të studimit, duke përdorur teknikën “peer to peer”, e cila ka shërbyer më së miri për përmirësimin e pikave të dobëta. P.sh., Në fokus ka qenë zbatimi i kombinimit të efektshëm i të folurit të pedagogut gjatë prezantimeve, duke përdorur teknologji të komunikimit, por dhe i ruajtjes së një raporti të balancuar sidomos në orët e</p>

	<p>seminareve midis sasisë së kohës që flet pedagogu dhe sasisë së kohës që flasin studentët.</p> <p><i>Ref. 26. Projekti TEAVET</i></p> <p><i>Ref. 27. Projekti ENTRAL</i></p> <p><i>Ref. 19. Pjesëmarrje në sesione të organizuara nga Qendra e Trajnimit të Vazhduar</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Rezulton nga krahasimi i CV-ve të personelit akademik të Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit me llojin e lëndës që zhvillon çdo PAE dhe PAK, se zhvillimi i lëndëve bëhet në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre, si edhe çdo PAE/PAK e zhvillon mësimdhënien sipas përvojës vetjake dhe sipas kërkesave të dokumenteve rregullatorë të miratuara të njësisë kryesore/bazë.</p> <p>Personeli akademik që është i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi është me grada dhe tituj akademikë si dhe kanë përvojë të gjatë në mësimdhënie. Kualifikimet e tyre dhe angazhimi i vazhdueshëm me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare në mësimdhënie dhe të nxënë ka mundësuar që stafi të përdorë në mënyrë efektive metodat tradicionale dhe bashkëkohore të mësimdhënies. Kodi i Etikës i UST i miratuar vite më parë, ka vendosur mënyra të detyrueshme sjelljeje nga personeli akademik, „si kundrejt njëri-tjetrit, ashtu edhe kundrejt studentëve, shkelja e të cilave pas sjell pasoja për të gjitha palët e përfshira.</p> <p><i>Ref. 26. Projekti TEAVET</i></p> <p><i>Ref. 27. Projekti ENTRAL</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion, nga takime me grupe të ndryshme studentësh, por edhe nga konsultimi me dokumentacionin e paraqitur në RVB, konstatohet se për vlerësimin e procesit dhe të formave dhe të metodave të mësimdhënies merret edhe mendimi i studentëve. Forma kryesore e marrjes së mendimit të studentëve është përmes anketimit dhe fokusgrupeve. Raportet e këtyre aktiviteteve paraqesin edhe sugjerime të studentëve për përmirësimin e metodave të mësimdhënies.</p>

	<p><i>Ref. 26. Projekti TEAVET</i></p> <p><i>Ref. 27. Projekti ENTRAL</i></p> <p><i>Ref. 48. Raport i vlerësimit të brendshëm periodik</i></p> <p><i>Ref. 35. Analiza vjetore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit</i></p> <p><i>Ref. 8. 3. Raport vjetor i punës së NjSBC</i></p> <p><i>Ref. 8. 2. Model Pyetëtori</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, por edhe për të plotësuar kërkesat ligjore, UST ka miratuar Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, e cila synon të përcaktojë funksionimin dhe organizimin e këtij sistemi, përmes rregullimit dhe standardizimit të vlerësimit të proceseve në UST. Kjo rregullore synon, midis të tjerash, përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përmbushur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë UST dhe çdo njësi të saj duke garantuar, gjithashtu, se mësimdhënia dhe kërkimi shkencor në UST të jetë në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Rregullorja ka për qëllim, zhvillimin e cilësisë përmes përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, miratimit të treguesve të cilësisë në kuadër të “vlerësimit të jashtëm”, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Rregullorja përcakton se në nivel fakulteti, përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti); - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.); - Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.) <p><i>Ref.8. 1. Rregullore për sigurinë e cilësisë</i></p> <p><i>Ref. 48. Raport i vlerësimit të brendshëm periodik</i></p> <p><i>Ref. 8. 3. Raport vjetor i punës së NjSBC</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rezulton se personeli akademik, i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në</i></p>

	<i>"Mësuesi në Edukim Fizik e shëndetësor", bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e performancës individuale dhe të aftësive mësimdhënëse. Personeli akademik përdor forma të larmishme të mësimdhënies, të të nxëniet, si edhe të transmetimit të dijeve. Këto forma i nënshtrohen përmirësimeve të vazhdueshme nga një personel akademik që zhvillon ato lëndë mësimore që janë në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kriteret, mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve, si edhe e aftësive profesionale të studentëve, parashikohet në dokumentet rregullatorë të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit; - Rregulloren e Programit të Studimit; <p>Rregullorja e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit përcakton se forma e kontrollit të dijes në UST është provimi me shkrim. Më pas, tregohet sistemi i vlerësimit me pikë, nota kaluese më e ulët, si edhe mënyra e vlerësimit përfundimtar, e cila përlllogaritet si shumë e ponderuar e vlerësimeve të provimit të ndërmjetëm, atij përfundimtar, si edhe të detyrave/projekteve/eseve/aktivizimit. Përveç detyrimit të pedagogëve që të informojnë studentët për mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe të njohurive, përcaktohet se kontrolli i dijeve mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me shkrim, me gojë, ose i kombinuar; - Me detyra kursi ose projekte; - Me punime të pavarura me shkrim ose prezantime; <p>Kriteret, mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale tregohet në çdo program lëndor dhe bëhet</p>

Guato



	<p>i njohur nga pedagogu që zhvillon lëndën prej prezantimit të parë me pedagogun.</p> <p><i>Ref. 2. Rregullore e UST</i> <i>Ref. 5. Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit</i> <i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentet shoqëruese të RVB-së, konstatohet se në të gjitha programet lëndore (syllabuset), në një rubrikë të veçantë tregohet edhe forma e kontrollit të dijeve, vlerësimi i frekuentimit, si edhe mënyra e realizimit të kontrollit të vazhdueshëm. Në këtë rubrikë jepen edhe mënyra e përllogaritjes së vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Menjëherë pas prezantimit të lëndës prej pedagogut në fillim të vitit akademik, studentëve u bëhet e njohur edhe metodologjia e plotë dhe e detajuar e mënyrës së vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Vlerësimi i studentëve bëhet me 30 % nëpërmjet provimit të ndërmjetëm dhe me 70 % në provimin përfundimtar. Në rastet kur lënda ka ushtrime ky raport është 30,%; 35 % dhe 35 %. Por edhe provimi i ndërmjetëm mund të vlerësohet me 20 pikë nëse merren në konsideratë detyrat, projektet apo aktivizimi i studentëve.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Mënyrat e ndryshme të testimit dhe të vlerësimit të njohurive tregohen në Rregulloren e Programit të Studimit, ku përcaktohet se kontrolli i dijeve mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me shkrim, me gojë, ose i kombinuar; - Me detyra kursi ose projekte; - Me punime të pavarura me shkrim ose prezantime. <p>Përveç mënyrës së treguar në mënyrë të përgjithshme në rregullore për vlerësimin e dijeve dhe njohurive, çdo pedagog i veçantë gjatë hartimit dhe miratimit të programeve lëndore përcakton edhe mënyrën konkrete të vlerësimit për çdo lëndë,</p>

Qesto



	duke marrë për bazë specifikat dhe kategorinë e lëndëve që zhvillohen.			
	Ref. 6. Rregullore e programit të Studimit			
Konkluzione	Gjatë zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor" për vlerësimin e studentëve, përdoren kritere të qarta dhe mënyra të larmishme të testimit e vlerësimit të njohurive. Çdo dokument që përmban kriteret e testimit dhe të vlerësimit të njohurive është i hapur dhe i njohur për studentët. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit inkurajon përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Në UST, siç është treguar edhe më sipër në këtë RVJ gjatë analizës së kriterëve të mëparshme, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve, si edhe e aftësive profesionale të studentëve parashikohen kryesisht në Rregulloren e Departamentit² të Edukimit dhe Shëndetit në zërin Vlerësimi i studentëve. Në këtë zë, përcaktohet se vlerësimi i dijeve dhe njohurive bëhet përgjatë gjithë vitit akademik përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimit të provimit të ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e shtatë/tetë të semestrit dhe që përmban 40% të vlerësimit përfundimtar; - Zhvillimit të provimit përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e pesëmbëdhjetë/gjashtëmbëdhjetë të semestrit dhe që përmban 50% të vlerësimit përfundimtar;

Guot



	<p>- Detyrave/projekteve/eseve/aktivizimit të cilat zhvillohen apo vlerësohen gjatë gjithë semestrit dhe që përmbajnë 10% të vlerësimit përfundimtar;</p> <p>Çdo pedagog i veçantë gjatë hartimit, miratimit, si edhe zbatimit të programeve lëndore, përcakton edhe mënyra të tjera specifike të vlerësimit për çdo lëndë, duke marrë për bazë specifikat dhe kategorinë e lëndëve që zhvillohen.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Ref. 33. Model komisioni provimesh</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UST, krahas vlerësimit “paper based test” dhe vlerësimit me gojë, zbaton edhe vlerësimin elektronik, që nënkupton hartimin, postimin dhe prezantimin/mbrojtjen e detyrës/projektit të kursit. UST, FShL ofrojnë sisteme elektronike testimi dhe vlerësimi, nëpërmjet Clean Score. Krahas vlerësimit tradicional me shkrim në auditor është vënë në zbatim sistemi elektronik i testimit dhe vlerësimit, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjes së nënshkruar me Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit (AADF) për përdorimin e sistemit CleanScore, diçka që rrit transparencën, lehtëson procesin e vlerësimit dhe eliminon abuzimet e mundshme.</p> <p>Tezat e provimit të ndërmjetëm dhe ato të provimit përfundimtar zhvillohen nga titullarët e lëndëve. Studentët merren në provim nga dy pedagogë dhe është e palejuar hyrja e njerëzve të tjerë gjatë procesit. Kryekomisionar është sërish titullari i lëndës.</p> <p><i>Ref. 2. Rregullore e UST</i></p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i></p> <p><i>Ref. 12. Marrëveshje me Clean Score</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Rezulton se mënyra e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të studentëve, gjatë zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor", por edhe vlerësimi përfundimtar i studentëve, bëhet sikurse është përcaktuar në çdo program lëndor dhe që është bërë publike përpara fillimit të vitit akademik. Provimet</p>

	<p>vlërësohen nga pedagogu/pedagogët që kanë zhvilluar lëndën. Hartimi i testit përmbledhës miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Fleta e vlerësimit firmoset nga dekani dhe kryesekretari.</p> <p><i>Ref. 2. Rregullore e UST</i> <i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, si edhe nga takimet me personelin akademik të Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, si dhe me studentët që ndjekin programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor" u konstatua se pedagogët e lëndëve që përfshihen në zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, në mënyrë të vazhduar përgjatë gjithë vitit shkollor, u japin komente studentëve, me shkrim ose me gojë, për çdo etapë të vlerësimit të vazhduar (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, projekt, ese), me qëllim përmirësimin e performancës së studentëve në të ardhmen.</p> <p>Dita e caktuar nga lektori për zhvillimin e provimit nuk duhet të jetë më pak se 48 orë përpara dhe rezultatet e provimit qëndrojnë deri në 5 ditë online. Vetë studenti në rast ankese nuk duhet të kalojë 2 ditë pas marrjes së rezultatit. Pedagogët zhvillojnë orë këshillimi në rast se u kërkohet një gjë e tillë nga studentët para provimeve.</p> <p><i>Ref. 2. Rregullore e UST</i> <i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Salla e provimit monitorohet nga departamenti dhe sekretaria mësimore. Në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë, përveç pedagogut të lëndës, koordinatores që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar sipas rastit nga departamenti. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë për asnjë rast. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse. Konsiderohen shkelje të rregullave të UST-s të gjitha veprimet e kryera me dashje nga studenti, përfshirë ato që përbëjnë cenim të normave shoqërore dhe etiko-morale, si: kopjimi, plagjiatura a paraqitja</p>

	<p>si punë e vet e punës së një tjetri; dhënia ose marrja e informacionit me gojë a me shenja gjatë provimit. Ndaj studentit që kryen veprime të tilla merren masa disiplinore sipas rastit: vërejtje me shkrim, përjashtim për një vit nga UST apo përjashtim përgjithmonë.</p> <p><i>Ref. 2. Rregullore e UST</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Siç është përmendur edhe në analizën e kriterëve të mëparshme në këtë RVJ, mënyra e zhvillimit të provimit përcaktohet nga Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes. Ndërsa në rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit tregohet procedura që duhet të ndjekin studentët për ankimimin e rasteve të ndryshme, apo edhe për ankimimin e rezultateve të provimeve.</p> <p>Vlerësimet dokumentohen në fletën e vlerësimit dhe në regjistrin e rezultateve akademike. Fleta e vlerësimit plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 10 ditë nga dita e provimit ose e prezantimit të detyrës së kursit. Fleta e vlerësimit firmoset nga Dekani dhe kryesekretari. Pedagogu bën me dije rezultatet e provimit brenda 5 ditëve, Studentët informohen në librezën e tyre elektronike ose tek sekretaria mësimore.</p> <p><i>Ref. 2. Rregullore e UST</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pedagogu i lëndës i shpall notat në mënyrë jo zyrtare, para se t'i regjistrojë të njëjtat, me qëllim që t'u jepet mundësia studentëve për shpjegim lidhur me notat e vendosura. Në rast se studenti mendon se ka pasur gabim në llogaritjen e pikëve dhe të notës ose gjatë shënimit të notës, ka të drejtë të kontaktojë pedagogun e modulit/ lëndës dhe të diskutojnë për vlerësimin. Nëse kërkesa e tij gjendet e justifikuar, bëhet ndryshimi i duhur sipas procedurës, para se nota të regjistrohet. Mbas këtij afati dy ditor nota bëhet përfundimtare dhe regjistrohet në sistemin Pitagora.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 40. Marrëveshje me sistemin Pitagora</i></p>

<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas Rregullores së Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit , tregohen edhe procedurat që duhet të ndjekin studentët për ankimimin e rasteve procedurave të ndjekura apo për ankimimin e rezultateve të provimeve. Ankesa e studentit i drejtohet me shkrim drejtuesit të njësisë kryesore, i cili e delegon ankimin tek drejtuesi i njësisë bazë. Drejtuesi i njësisë bazë i paraqet drejtuesit të njësisë kryesore një relacion shpjegues dhe më pas, drejtuesi i njësisë kryesore vendos miratimin apo refuzimin e ankimit të studentit. Nëse ankimi i studentit miratohet, drejtuesi i njësisë kryesore ngre një komision ad-hoc, i cili ndjek një procedurë të përcaktuar qartë për të ndryshuar apo jo vlerësimin fillestar të studentit. Procedura që ndiqet për raste të tilla, arkivohet sipas kërkesave të përcaktuara në Rregulloren për Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UST.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 6. Rregullore e programit të studimit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rezulton se në UST, gjatë gjithë procesit të zhvillimit të programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor” testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe përmes formave të larmishme.</i></p> <p><i>Provimi përfundimtar zhvillohet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në mënyrë të qartë. Gjithashtu, studentët kanë të drejtën e njohjes me vlerësimin dhe të drejtën e ankimimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave (120 kredite) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” me dy vite akademike synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përgatisë studentë për një praktikë efektive, të përgjegjshme dhe krijuese të mbështetjes, kujdesit dhe progresit të vijueshëm të fëmijëve në klasë, në shkollë, si dhe në bashkëpunimin me prindërit, kolegët dhe komunitetin; • Të përgatisë studentë të praktikojnë këtë shërbim në kuadrin e vlerave bazë dhe standardeve etike në profesionin e mësuesit; • Të pasurojë programin duke iu ofruar mundësi studentëve të rritin ndjeshmërinë, njohuritë dhe të kuptuarit e fëmijëve, si dhe t’u japin zgjidhje problemeve; • Të ofrojë një bazë të qëndrueshme edukimi për studentët, të cilët mund të jenë të interesuar për transferimin dhe vazhdimin e studimeve në nivele të tjera të dëshiruara; <p>Programi synon një kualifikim teorik dhe praktik të studentëve krahasuar me nivelin e ciklit të parë, si edhe synon të japë kontribut për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ngritjes së standardeve të mësuesit duke bashkëpunuar dhe ndihmuar shkollat që ushtrojnë veprimtari në këtë hallkë të arsimit të nxënësve. Programi mundëson, gjithashtu, studime të thelluara në mësimdhënie, në procesin e të nxënësve, si edhe në fushën e arsimit të rriturve.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Zbatimi i Planit Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi Edukim fizik e shëndetësor”, përmes zhvillimit të lëndëve specifike, parashikon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit përmes zhvillimit të lëndës Teknologjitë në Edukim; - Zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e pedagogji – psikologjisë përmes zhvillimit të lëndëve Psikologji Zhvillimi; Metodatat e Kërkimit Shkencor; Modelet e mësimdhënies dhe të nxënësve; Menaxhimi i klasës, Kurrikula dhe Arsimi gjithëpërfshirës; Praktikë profesionale pedagogjike, etj;

	<p>- Zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e edukimit fizik dhe shëndetit përmes zhvillimit të lëndëve: Edukim Fizik dhe Shëndet; Biologji; Shëndeti dhe gjendjet kritike në moshën shkollore; Metodikë e lojërave lëvizore; Organizim i Edukimit fizik dhe Sportit; Metodikë e Atletikës; Metodikë e Sporteve Atletike; Koncepti i Mirëqenies Fizike dhe Shëndetit; Kieziologji; Trainingu; , Praktikë profesionale pedagogjike në Edukim Shëndetësor, etj;</p> <p><i>Ref. 2. Rregullore e UST</i></p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor"</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Gjatë raportimit kemi përmendur në vazhdimësi në këtë RVJ, qysh prej prezantimit të lëndës prej pedagogut në orën e parë mësimore, studentët janë të qartë për kompetencat dhe aftësitë që ata duhet të fitojnë dhe zotërojnë. Gjithashtu, në përfundim të programit të çdo lënde, studentët vlerësohen përmes një metode të kombinuar: përmes provimit të ndërmjetëm, përmes provimit përfundimtar, si edhe përmes pjesëmarrjes në detyra kursi, ese, prezantime etj.</p> <p>Në analizën e departamentit apo edhe të UST shqyrtohet gjerësisht niveli i kompetencave profesionale të fituara nga studentët në përfundim të lëndëve, sfidat në arritjen e tyre, efektiviteti i metodave të zbatuara në mësimdhënie, përfshirja dhe aktivizimi i studentëve në mësimdhënie dhe të nxënë. Të gjitha këto kanë synim t'i përmirësojnë në të ardhmen këta tregues.</p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e programit Master Shkencor</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në Institucion zhvilloi dhe bisedat me studentët e programit të studimit, ku u konstatua se mësimdhënia që zhvillohet në këtë departament, bazohet në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe qëndrimeve të studentëve, duke u ofruar atyre mundësi për zhvillimin e njohurive që lidhen si me përgatitjen e tyre shkencore, ashtu dhe me përgatitjen pedagogjike.</p>

<p>diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Gjatë zhvillimit të procesit mësimor në të gjitha lëndët, pedagogët krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve krijuese dhe mendimin kritik e shkencor të studentëve. Staf i inkurajon studentët të zhvillojnë ide dhe t'i bëjnë të zbatueshme ato në fushat përkatëse dhe profesionin e tyre në mësimdhënie e të nxënë. Puna në grupe të vogla zë një vend të rëndësishëm ndërmjet metodave të mësimdhënies në UST për arsye akademike, sociale dhe edukative. Puna në grup krijon një kontakt social që është shumë i nevojshëm, veçanërisht, për studentët. Njëpërmjet punës në grup, UST synon të zhvillojë te studentët aftësi intelektuale të tilla, si: arsyetimi, zgjidhja e problemeve, mbajtja e qëndrimeve dhe aftësi ndërpersonale (të dëgjuarit, të folurit, të bashkëbisedimit, të drejtimit). Për forcimin e këtyre aftësive, personeli akademik organizon projekte/detyra kursi me grupe studentësh. Gjatë zhvillimit të procesit mësimor në të gjitha lëndët pedagogët krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative të studentëve. Edhe departamentet i krijojnë pedagogëve dhe studentëve mundësi për përfshirje në projekte kërkimore, studime të avancuara,</p> <p><i>Rekomandohet që të punohet për të shtuar përpjekjet për rritjen e mobilitetit të studentëve nga ky program studimi.</i></p> <p><i>Ref. 6. Rregullore e programit Master Shkencor</i> <i>Organizimi i sesioneve shkencore në Departament</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Për këtë qëllim, realizohen diskutime të stafit për ndarjen e përvojave më të mira dhe për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave të fituara përmes mobilitetit të stafit në universitete të tjera evropiane, pjesë e programit Erasmus+. Kjo përfshin sesione bashkëbisedimesh, ku personeli akademik ndajnë me njëri-tjetrin me praktikat më të suksesshme dhe mësimet e nxjerra nga përvojat e tyre të huaja. Ky proces i shkëmbimit të njohurive shërben për të pasuruar ambientin akademik dhe për të siguruar një perspektivë ndërkombëtare në zhvillimin e veprimtarive të universitetit. UST ka zbatuar politikën e përfshirjes së lektorëve dhe kërkuesve shkencorë në faza të ndryshme të procesit mësimor si element të rëndësishëm për shkëmbimin e ideve dhe metodave të mësimdhënies.</p>

	<i>Ref. 27. Projekti ENTRAL</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	<p>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit është një ambient ku stimulohet dhe promovohet bashkëpunimi mes departamenteve në realizimin e projekteve inovative. Në këtë kontekst, institucioni aktivisht inkurajon dhe mbështet financiarisht projektet që dalin nga bashkëpunimi midis departamenteve, duke e parë këtë si një mjet të rëndësishëm për të nxitur ide inovative dhe për të përparuar studimet kërkimore nga ana e studentëve. Projektet që lidhen me shkëmbimin e ideve dhe resurseve midis departamenteve shërbejnë si një mjet për të thelluar bashkëpunimin në fusha të ndryshme të zhvillimit të dijes. Përveç kësaj, konferencat studentore ofrojnë një platformë ku studentët mund të paraqesin punën e tyre, duke ndarë idetë e tyre me një audiencë të gjerë dhe duke kontribuar kështu në krijimin e një mjedisi të pasur intelektual dhe kulturor. Përmes mbështetjes financiare, institucioni shfaq përkushtim ndaj zhvillimit të njohurive dhe ideve inovative të studentëve, krijon një mjedis të stimulueshëm për rritjen e dijes dhe krijimin e një komuniteti akademik të pasur dhe të përfshirë. UST mbështet idetë bashkëkohore të studentëve dhe iu krijon mundësi për përfshirje në projekte kërkimore e studime të avancuara.</p> <p><i>Ref. 22. Miratim projektesh shkencore (Vendime senati dhe vendime Bordi administrativ)</i></p> <p><i>Ref. 44. Miratim konferencash shkencore (Vendime senati dhe vendime Bordi administrativ)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Zbatimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave "në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor", parashikon zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të ndryshme me natyrë teknologjike/ pedagogjike/ sportive dhe shëndetësore. Këto aftësi analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndëve të ndryshme dhe programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, si dhe Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” dhe Rregullorja e Diplomimit përcakton:</p> <ul style="list-style-type: none"> - modalitetet që ndiqen për të zgjedhur Temën e kërkimit të diplomës; - përgatitja dhe vlerësimi i tezës së diplomës; - mbrojtja e tezës së diplomës; - organizimi i prezantimit të përgjithshëm përfundimtar të temës së diplomës; - mënyra e pajisjes me diplomën përkatëse, pasi studenti përmbush të gjitha detyrimet akademike; <p>Për të fituar diplomën Master i Shkencave (120 ECTS) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” në dy vite akademike, studenti duhet të japë provën finale, e cila mund të jetë një tezë kërkimi, një seri esesh, një projekt kërkimi, një dosje kërkimi, etj.</p> <p><i>Ref. 1. Ligji i IAL</i> <i>Ref. 2. Rregullorja e UST</i> <i>Ref. 4. Rregullorja e FShL</i> <i>Ref. 6. Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Ref. 18. Rregullorja e Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Kërkesat e çdo studenti që shprehin vullnetin e tyre për të zgjedhur mbrojtjen e temës së diplomës shqyrtohen në Departamentin e Edukimit e Shëndetit nga ku dalin edhe listat përfundimtare.</p> <p>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit nëpërmjet personelit akademik efektiv, organizon seanca orientuese, me qëllim sqarimin dhe udhëzimin e studentëve që do të për zgjedhin temat Studentët të cilët do të mbrojnë temë diplome kanë të drejtë që të përcaktojnë vetë temën që do të trajtojnë në punimin</p>

	<p>e diplomës. Rregulla më të hollësishme për të gjithë procesin e përmendur më sipër jepen në Manualin e posaçëm për punimin e temës së diplomës. Personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave(120 ECTS) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” mbështet dhe ndihmon studentët, duke iu dhënë atyre herë pas here informacion, udhëzime për materialet që duhet të përdorin dhe studiojnë në funksion të kërkimit që do të zhvillojnë.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 6. Rregullore e programit të Studimit</i> <i>Ref. 18. Rregullore e Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Për të fituar diplomën e studimeve master, studentët që ndjekin programet Master i Shkencave, përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit dhe kryerjes së praktikës, duhet t'i nënshtrohen edhe provës finale (mbrojtje e temës së diplomës). Paketa e provës finale përmban udhëzime për procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të provës finale; përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie. Pedagogë –studentë kanë të ndara detyrat e tyre në rregulloren e Departamentit ku përcaktohet edhe mënyra e punës (individ apo grup. me një udhëheqës apo dy , si edhe formati i tezës së diplomës).</p> <p><i>Ref. 1. Rregullore e IAL</i> <i>Ref. 2. Rregullore e UST</i> <i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Ref. 18. Rregullore e Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston</p>	<p>Studentët e programit të studimit Master i Shkencave (120 ETC) në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” i nënshtrohen përzgjedhjes së temës së kërkimit. Kur kemi tezë diplome siç është rasti i Masterit Shkencor, me vendim senati këtyre studentëve u caktohet udhëheqësi nga stafi i departamentit dhe miratohet komisioni i diplomimit për mbrojtjen e tezës.</p>

<p>studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas udhëzuesit, udhëheqësi i diplomës duhet të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve, si edhe përgatitjen e punimit. Gjithashtu, udhëheqësi i diplomës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson rregullisht progresin e studentit kryesisht përmes raporteve të shkruara nga vetë studenti; - monitoron punën e studentit përkundrejt standardeve të kërkuara; <p>Në fund të procesit, udhëheqësi i diplomës konfirmon se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës.</p> <p><i>Ref. 1. Rregullore e IAL</i> <i>Ref. 2. Rregullore e UST</i> <i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 6. Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Ref. 18. Rregullore e Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga konsultimet me dokumentacionin që lidhet me infrastrukturën fizike të UST-së, por edhe nga takimet e realizuara me studentët që ndjekin Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor" u konstatua se në ambientet e UST-së janë në dispozicion të studentëve mjedise të mjaftueshme për të punuar për përgatitjen në punimin e temës së diplomës: në veçanti mund të përmenden ambientet e bibliotekës dhe të laboratorit të teknologjisë. Këto mjedise mund të përdoren nga studentët diplomantë si për përgatitjen e përgjithshme të temës së diplomës, ashtu edhe për hedhjen e të dhënave tabelore, grafike dhe të bërtjes së analizave statistikore, në varësi të specifikave të temës së zgjedhur.</p> <p>Pedagogu udhëheqës trajton me studentin çështje të tilla, si: metodologjia, përpunimi i dhënave, paraqitja e të dhënave (diagrame, kurba etj), puna në terren, planifikimi, zbatimi,</p>

	<p>raportimi i gjetjeve/të dhënave etj. Gjatë dy ditëve që ne qëndruam në universitet studentët prisnin ndarjen në grupe pune dhe caktimin e pedagogut udhëheqës. Ata na sqaruan se si grup punonin mirë sepse përzgjidhnin matjet që duhet të bënin, trajtimin teorik apo shpjegimin praktik të të dhënave të nxjerra.</p> <p><i>Ref. 2. Statuti i UST</i> <i>Ref. 2.3. Rregullore e UST</i> <i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 18. Rregullore e Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Siç e parashikon edhe Rregullorja e Programit të studimit, mbështetur në procedurën e diplomimit dhe programin mësimor të Masterit Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” (120 ETC) studentit në diplomimin final me tezë kërkimore vlerësohet me notë dhe me kreditet e fituara.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 18. Rregullore e Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Pas përfundimit me sukses të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” dhe pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare ndaj universitetit, studentit pajiset me Diplomën dhe Suplementin e saj, të miratuara në QSHA. Nëse studentit e kërkon, atij i vendoset në dispozicion edhe një kopje e plotë e programit mësimor të zhvilluar përgjatë tre viteve.</p> <p><i>Ref. 2. Statuti i UST</i> <i>Ref. 2.3. Rregullore e UST</i> <i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i> <i>Ref. 18. Rregullore e Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti</p>	<p>UST e përpunon informacionin e krijuar për studentin gjatë veprimtarisë së tij akademike dhe administrative sipas kërkesave specifike të përcaktuara në Rregulloren për Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UST.</p>

informacione për studentin nëse kërkohen.	<p>Çdo student i veçantë, mbi bazën e kërkesës së tij, mund të kërkojë në çdo kohë informacione që lidhen me jetën e tij akademike, brenda kufijve të caktuara në aktet rregullatore të universitetit, si edhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arkivat në Republikën e Shqipërisë. Në arkivin e UST ruhet për një periudhë të pacaktuar në sekretari një kopje e dokumentacionit të secilit student.</p> <p><i>Ref. 2. Statuti i UST</i> <i>Ref. 2.3. Rregullore e UST</i> <i>Ref. 4. Rregullore e FShL</i></p>											
Konkluzione	<p><i>Në përfundim të studimeve, për programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor" parashikohet alternativa për vlerësimin përfundimtar të studentëve: Temë diplome. Parashikohen rregulla shumë të qarta për mënyrën e përgatitjes, zhvillimit, si edhe të vlerësimit të procesit të punës së diplomës. Pas prezantimit të diplomës ose zhvillimit të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset me Diplomë dhe Suplementin e saj.</i></p>											
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X			
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht									
			X									

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës</p>	<p>N/A</p>




laboratorike, praktikës profesionale.				
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N/A			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N/A			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi IV. 1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


Busto



Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																					
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Grupi i RVJ, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga Institucioni UST, Fakulteti i Shkencave të lëvizjes dhe Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, gjatë inspektimit dy ditorë në institucion, si dhe nga bisedat me stafin drejtues përkatës, konstatoi që personeli akademik, i cili është i gjithë me kohë të plotë, ashtu si edhe personeli ndihmës, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, zotëron nivelin e dëshiruar profesional dhe akademik për përmbushjen me sukses të programit të Studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”. Mbulimi i lëndëve në përmbajtje të Kurrikulës ekzistuese, është në përputhje me kualifikimin e çdo pedagogu, sipas frymës së ligjit dhe rregulloreve përkatëse. GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit bazuar në tabelat 6.1-6.3 është: 1 – 6.3 është:</p> <table border="1" data-bbox="603 1048 1394 1563"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc</td> <td>10</td> <td>-</td> <td>8</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>6</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc (Dr proc)</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>24</td> <td>0</td> <td>20</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>Sipas përcaktimeve ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015), personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi Master i Shkencave, angazhohen 3 staf akademik me Msc, por që janë në proces doktorature.</p>				Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	5	-	4	-	Prof. Asoc	10	-	8	1	Dr./PhD	6	-	5	-	Msc (Dr proc)	3	-	3	-	Totali	24	0	20	1
Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK																																		
Prof.Dr	5	-	4	-																																		
Prof. Asoc	10	-	8	1																																		
Dr./PhD	6	-	5	-																																		
Msc (Dr proc)	3	-	3	-																																		
Totali	24	0	20	1																																		

Qesto





	<p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit.</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndet”</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga Institucioni, konstatoi që ky program studimi mbulohet 100 % nga staf akademik efektiv (PAE), duke plotësuar kështu kërkesat ligjore në lidhje me mbulimin e ngarkesës nga stafi akademik efektiv. Personeli akademik në UST kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UST, këshillim për studentët, tutoriat si dhe veprimtari të tjera.</p> <p><i>Ref.14. Marrëveshjet (Ngarkesa e Pedagogëve)</i></p> <p><i>Ref.47. Tabelat Përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me zyrën e burimeve njerëzore u konstatua se, institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik efektiv të cilat janë të përfshira në Rregulloren për rekrutimin e personelit akademik. Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore ishte i gjithë dokumentacioni në lidhje me stafin akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p>GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin e paraqitur nga Institucioni, dhe vizitës dy ditore në institucion, konstatoi që personeli akademik që realizon programin e Studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” është i qëndrueshëm për gjithë periudhën e akreditimit të këtij programi, e pasqyruar kjo në kontratat e punësimit që mbulojnë sigurime shoqërore dhe shëndetësore për stafin aktiv në program.</p> <p><i>Ref.9. Burimet Njerëzore</i></p> <p><i>Ref. 9.1. Kontrata e Punës</i></p> <p><i>Ref.36. Struktura Analitike e Personelit Akademik</i></p> <p><i>Ref. 47. Tabelat Përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si</p>

Bueto




<p>vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>dhe nga takimet me stafin drejtues të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe të Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, konstatoam që procedura e rekrutimit, ndiqet dhe zbatohet rigorozisht nga hallkat përgjegjëse, me synim përzgjedhjen e stafit të ri, me nivelin e dëshiruar të kualifikimit, që përputhet me natyrën, strukturën dhe modulet lëndore që ata do mbulojnë. Vlerësimi i kandidatave është bërë nga një komision ad hoc, i përbërë nga 5 persona, pa konflikt interesi me konkurruesit. Personeli Akademik, është mbështetur nga këto kriteret:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Plotësimi i kriterëve të përgjithshme, 20% e vlerësimit; -Plotësimi i kriterëve specifike, 40% e vlerësimit; -Plotësimi i kriterëve preferenciale, 10% të vlerësimit; -Performanca në intervistë, 30% të vlerësimit; <p>Dokumentacioni i vëzhguar nga Grupi, e pasqyrore saktë zbatimin e standardit ligjor.</p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së (neni 31)</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit (neni 13)</i></p> <p><i>Ref.9. Burimet Njerëzore. (Rregullore e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik.)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, dhe në vizitat në institucion, konstaton se Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, i cili përgjigjet për zbatimin me sukses të programit të Studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor”, ka në dispozicion gjithsej 5 personel ndihmës akademik. Nga ky numër, vetëm një person ndihmës akademik, shërben brenda Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, mjaftueshëm për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit (neni 13)</i></p> <p><i>Ref.9. Burimet Njerëzore. (Rregullore e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik.)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh dhe administron të dhënat e personelit akademik, më kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Për çdo anëtar të stafit ka dosje individuale. Gjithashtu nga kjo zyrë</p>

<p>personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>mbahet edhe evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore. Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore gjendet i gjithë dokumentacioni në lidhje me stafin akademik efektiv, atij ndihmës dhe administrativ. Pranë zyrës së burimeve njerëzore ruhen dosjet e PAE, të cilat përditësohen çdo fundviti akademik me aktivitetin shkencor dhe CV-të e stafit përkatës. Duhet të qartësojmë se programi i studimit është në vitin e dytë të realizimit dhe dokumentacioni pasqyron rezultatet e një viti akademik.</p> <p><i>Ref.7. Plani mësimor i Programit i Studimit MEFSH-B (Exeli me emrat e pedagogëve)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, dhe takimet në zyrat përkatëse të administratës, takimet me stafin drejtues të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe të Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, konstatoi që Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, i cili përgjigjet për zbatimin me sukses të programit të Studimit, kanë hartuar kontrata dhe programe bashkëpunimi, mbështetur në Statutin e UST-së (neni 7) si dhe Rregulloren e Praktikës Mësimore dhe Praktikës Pedagogjike, me Drejtoritë Arsimore dhe Zyrat Vendore Arsimore, duke vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm arsimor, për ndjekjen e studentëve në praktikën profesionale, për përgatitjen e punimit të diplomës si dhe veprimtari të tjera, që parasheh programi i studimit.</p> <p><i>Statuti i UST-së (neni 7)</i></p> <p><i>Rregulloren e Praktikës Mësimore dhe Praktikës Pedagogjike</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, dhe takimet në zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me stafin drejtues të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe të Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, konstatoi që Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, i cili përgjigjet për zbatimin me sukses të programit të Studimit, kanë caktuar personel mbikëqyrës, i cili është angazhuar për përmbushjen me sukses të praktikës profesionale, që studentët zhvilluan sipas programit të studimit në fuqi, në përmbushje të detyrimeve akademike. Ky personel po ashtu ka marrë pjesë edhe në procesin e vlerësimit, në përfundim të praktikës profesionale.</p>

Queto



vlerësimi të tyre për praktikën profesionale.	<p>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit (neni 19)</p> <p>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master I Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndet”(neni 13)</p> <p>Ref.23. Rregullore e Praktikës Mësimore dhe Praktikës Profesionale. (neni 8)</p>			
Konkluzione	<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit të studimit. Institucioni garanton qëndrueshmëri në rekrutimin e personelit akademik, si dhe ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Institucioni lidh marrëveshje me institucione, apo organizma të tjera, për të siguruar ambientin e nevojshëm për realizimin e praktikave profesionale, të cilët e asistojnë studentin në zhvillimin e këtyre praktikave;</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV. 2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të</p>	<p>GVJ, bazuar në vizitën dy ditore në ambientet sportive dhe zyrat e UST-së si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor”, konstaton se UST ka vënë në shërbim të përmbushjes së programit të studimit, mjedise të mjaftueshme si në aspektin sportiv, fusha sportive të mirëmbajtura dhe të mirë pajisura me mjete didaktike të kohës, terrene sportive, nga të cilët një në ndërtim e sipër, palestra të</p>

<p>programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>lojërave me dorë, palestër gjimnastike, laboratorë modern, të përfituar nga projekte ndërkombëtare si Projekti SPEED, etj.</p> <p>Sallat e leksioneve janë të bollshme dhe të mirë pajisura. <i>Nga takimi me studentet, mësuam se një pjesë e pajisjeve kompjuterike, kanë nevojë të rinovohen.</i> GVJ, ia përcolli stafit drejtues te njësisë administrative këtë shqetësim dhe kërkesë të studentëve.</p> <p><i>Ref.1. Ligji i IAL-së</i></p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së(neni 87)</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore e FSHL-së (neni53)</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>UST ka vënë në shërbim të përmbushjes së programit të studimit, mjedise të mjaftueshme si në aspektin sportiv(fusha sportive të mirëmbajtura dhe të mirë pajisura me mjete didaktike të kohës, terrene sportive, nga të cilët një në ndërtim e sipër, palestra të lojërave me dorë, palestër gjimnastike, laboratorë modern, të përfituar nga projekte ndërkombëtare si Projekti SPEED, etj.) Sallat e leksioneve janë të bollshme dhe të mirë pajisura.</p> <p><i>Ref.28. Info mbi laboratorët në UST-Manual Pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>UST ka vënë në shërbim të përmbushjes së programit të studimit, laboratorë modern, me aparatura që ndihmojnë studentët të eksperimentojnë, masin dhe vlerësojnë të dhënat e tyre të vjelura nga puna kërkimore e shkencore në terren. Spikat Laboratori i Elektronikës, me aparaturat kryesore të Leonardo Mechanogrph (GFRP), Poltrona e Matjes së Forcës-“EasTech”, Sistemi i Shtrojave, MEDIZINTECHNIK GmbH, ”BROHUER TIMING SYSTEMS” etj</p> <p><i>Ref.28. Info mbi laboratorët në UST-Manual Pdf</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në RVB konstatoi se, institucioni ka një laborator të informatikës (IT) me parametra teknike të standardeve bashkëkohore, ku janë instaluar të gjithë programet e nevojshme për të mundësuar zbatimin e programeve.</p> <p><i>Ref.28. Info mbi laboratorët në UST-Manual Pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Gjatë vizitës në UST, GVJ pa nga afër gjithë praktikën shkresore, të manifestuar në rregulloren e UST-së, në Relacionin e infrastrukturës, në rregulloren e praktikës mësimore dhe praktikës pedagogjike, në bashkëpunimin institucional me Drejtorinë Arsimore për organizimin e praktikave mësimore, në shkollat në varësi të DAR-së.</p> <p>Të gjitha këto mundësi të ofruara, janë plotësisht të mjaftueshme për mbarëvajtjen me sukses të praktikës mësimore dhe praktikës profesionale të studentëve. Nëpërmjet hartave kadastrale, pasqyrohet qartë dhe saktë struktura dhe përmbajtja e mjedisëve që institucioni zotëron dhe vendos në shërbim të Programit të Studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor”</p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së (neni 115)</i> <i>Ref.39. Relacioni i Infrastrukturës së UST-së</i> <i>Ref.23. Rregullore e Praktikave Mësimore dhe Pedagogjike.</i> <i>Ref.46. Bashkëpunim me DAR mbi zhvillimin e praktikave profesionale.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</i></p> <p><i>Gjithashtu, konstatojmë se institucioni ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Bueto



Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentet e vëna në dispozicion, vizitën në institucion, në bibliotekë, takimin me stafin dhe studentët, konstatoi qartësisht se studentët mbulohen me literaturën e nevojshme Digjitale dhe Fizike, në funksion përbushjes së kërkesave të programit të studimit.</p> <p><i>Ref.11. Funksioni i Bibliotekës/ Infrastruktura</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse paraqet kërkesat për literaturën e nevojshme për lëndët e programit, ku përfshihen “Tekste bazë”, “Tekste të rekomanduara”. Njësia përgjegjëse, e ka në vëmendje të punës së saj, përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit, e cila është manifestuar në rinovimin e literaturës në ciklin e leksioneve të pedagogëve. GVJ u informua se stafi akademik çdo fund viti akademik përditëson syllabusin, temat përkatëse, literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, ciklin e leksioneve dhe bazuar në këtë përditësim bën dhe kërkesën për literaturë fizike apo on-line.</p> <p><i>Ref.11. Funksioni i Bibliotekës/ Infrastruktura</i> <i>Ref.29. Model Programi/Syllabi me Update të Literaturës</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e institucionit është në dispozicion të të gjithë studentëve, përfshirë edhe studentët e programit Master i Shkencave në “Edukim fizik e shëndetësor”. Biblioteka e UST-së është një hapësirë brenda mjediseve të universitetit.</p> <p>Biblioteka e UST-së, është tërësisht në shërbim të studentëve si në aspektin e shfrytëzimit fizik të literaturës, ashtu edhe në aspektin digjital, nëpërmjet Katalogimit të Përbashkët COBISS</p>

Beeto



	<p><i>Ref.11. Funkzioni I Bibliotekës/ Infrastruktura</i></p> <p><i>Ref.29. Model Programi/Syllabi me Update të Literaturës</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ,bazuar në vizitën në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit,konstatoi që fondi fizik i bibliotekës,përfshin libra dhe revista shkencore, tekste bazë dhe tekste ndihmës, të mjaftueshme për të mbuluar gjithë veprimtarinë mësimore brenda programit të studimit.</p> <p>Fondi fizik i librave nisur nga titujt është afërsisht 1546 tituj. llogaritur ne fashikuj ky numër është shumë herë më i lartë. Njëherazi, në fondin fizik të bibliotekës së UST-së, përfshihen me dhjetëra disertacione të mbrojtura në vite, si dhe një numër i lartë i Mikrotezave, që i ndihmojnë studentët të gjejnë materiale të vlefshme për kërkimin shkencor.</p> <p><i>Megjithatë në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në “ Mësuesi në Edukim fizik e Shëndetësor” në lëmin e mësuesisë fondi është i ulët, vetëm 134 tituj.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që në vazhdim ky numër të vijë duke u rritur sepse vizioni i mësuesit krijohet që në auditorët e tanishëm.</i></p> <p><i>Ref.11. Funkzioni i Bibliotekës//Infrastruktura</i></p> <p><i>Ref.29. Model Programi/Syllabi me Update të Literaturës</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Fondi i Bibliotekës, paraqitet në bazë të të dhënave elektronike, përmes regjistrimeve në Sistemin e Katalogimit të përbashkët COBISS.al dhe krijon kushte shfrytëzimi të barabartë dhe pa pagesë extra, për të gjithë studentët e përfshirë në programin e studimit.</p> <p><i>Ref.11. Funkzioni i Bibliotekës//Infrastruktura(ebsco.com academic libraries)</i></p> <p><i>Sistemin e Katalogimit të përbashkët COBISS.al</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>GVJ, gjatë vëzhgimit dhe monitorimit, në mjediset e Bibliotekës së UST-së,konstatoi se Fondi i Bibliotekës, paraqitet në bazë të të dhënave elektronike, përmes regjistrimeve në Sistemin e Katalogimit të përbashkët COBISS.al dhe krijon kushte</p>

Bofo

[Signature]

<p>shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>shfrytëzimi të barabartë dhe pa pagesë extra, për të gjithë studentët e përfshirë në programin e studimit.</p> <p>Biblioteka është e mirë pajisur me mjete teknike që mundësojnë studentët të përfitojnë pa kufizim, shërbime për të cilat ata interesohen.</p> <p><i>Ref.11. Funkzioni i Bibliotekës//Infrastruktura Sistemi i Katalogimit të përbashkët COBISS.al</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ, gjatë vëzhgimit dhe monitorimit, në mjediset e Bibliotekës së UST-së, konstatoi se mbështetur në rregulloren e Bibliotekës, Biblioteka punon nga e hëna në të premte, nga ora 08 - 20.00, në përgjigje të procesit mësimor dhe më tej.</p> <p><i>Gjate inspektimit që zhvilluam aty si GVJ sfida është të rritet qasja e numrit të studentëve me Bibliotekën, akoma dhe më tej. Nga takimi me studentët, konstatoam se për autorë shumë të njohur në fushën e tyre, kur u pyetën nga ana jonë, nuk kishin dijeni, kur në fakt, këta autorë ne i gjetëm në raftet e Bibliotekës gjate inspektimit që zhvilluam aty si GVJ.</i></p> <p><i>Ref.11. Funkzioni i Bibliotekës//Infrastruktura Sistemi i Katalogimit të përbashkët COBISS.al</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për</p>	<p>GVJ, gjatë vëzhgimit dhe monitorimit, në mjediset e Bibliotekës së UST-së, konstatoi se, biblioteka kryen veprimtari që përgatit dhe shpërndan informacion bibliotekar dhe informacion bibliografik.</p> <p>Biblioteka i drejtohet me një shkresë Departamentit dhe Departamenti, në mënyrë të detajuar, i dërgon stafit të Bibliotekës, listën më titujt përkatës që u siguruan nga stafi Bibliotekës.</p> <p>Biblioteka bën shkëmbim dhe huazim ndër bibliotekar në shërbim të studentëve të anëtarësuar. Vendos në shërbim të të anëtarësuarve, koleksionet e Bibliotekës në sallat e leximit, ose i huazon ato kur është e nevojshme. Biblioteka u krijon kushte të antarësuarve të fotokopjojnë materiale deri në 15-20 faqe, duke respektuar të drejtën e autorit dhe rregulloren.</p>


<p>pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Të dhënat mbi fondin e Bibliotekës dhe pasurimin e këtij fondi si dhe njoftimet që lidhen me veprimtarinë e Bibliotekës, janë të pasqyruara në Websitin e UST-së.</p> <p><i>Ref.11. Funkzioni i Bibliotekës//Infrastruktura Sistemi i Katalogimit të përbashkët COBISS.al</i></p> <p><i>Ref.30. Shkresa dërguar Departamenteve me kërkesa libra, revista etj</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se, Biblioteka ka një fond shumë të pasur fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore të programit Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor".</i></p> <p><u><i>Rekomandohet pasurimi i bibliotekës në fushën e mësuesisë.</i></u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB, Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, sekretaria e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, si edhe Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit, disponojnë një sistem të menaxhimit të informacionit të studentëve në hyrje dhe në dalje.</p> <p>Nga intervistat me punonjësit e Burimeve Njerëzore, por edhe nga vizita në Sekretarinë mësimore u pa se UST disponon bazën e të dhënave që përmban informacionin e plotë mbi studentët të tilla si: gjeneralitetet, datëlindja, programi i studimit që ndjekin, viti i studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datën e regjistrimit në universitet, datën e çregjistrimit dhe transferimit (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), datën</p>

Gueto



	<p>e diplomimit, etj. Këtë bazë të dhënash e plotësojnë, përditësojnë dhe e disponojnë sekretaritetë mësimore të secilit Fakultet dhe Sektori i IT dhe ia raportojnë organeve drejtuese kur nevojitet.</p> <p><i>Ref.2. Statuti I UST-së Kapitulli VI (neni 70.71)</i> <i>Ref.11. Funksioni i Bibliotekës//Infrastruktura</i> <i>Ref.40. Marrëveshja RASH/Pitagora</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga vizita në universitet, konstatuam gjithashtu se Zyra e Burimeve Njerëzore, disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ndërsa Departamenti monitoron dhe nxit aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor duke e ruajtur në dosje të veçanta.</p> <p>Sistemi PITAGORA është i aksesueshëm nga personeli akademik në ndihmë të procesit të mësimdhënies, studentët të cilëve ju mundëson përditësimin në kohë reale për procesin mësimor, vlerësime, frekuentim, programe lëndës, sylabusin etj. Në sistem janë të hedhura të dhënat për strukturën akademike, të dhënat e studentit vlerësimet kohë pas kohe deri në diplomim pranimin.</p> <p><i>Ref.2. Statuti I UST-së Kapitulli VI (neni 70.)</i> <i>Ref.11. Funksioni i Bibliotekës//Infrastruktura</i> <i>Ref.40. Marrëveshja RASH/Pitagora</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, sigurohet informacion për të gjithë personelin akademik dhe studentët. Në të gjenden edhe aktet rregullatorë të IAL-së. Sistemin elektronik të Pitgorës e përdor shumë dhe ndihmon në mbarëvajtjen dhe dokumentimin elektronik të punës edhe sekretaria mësimore, ku hedh të dhënat për studentët që nga regjistrimi, transferimet, vlerësimet sipas lëndëve dhe viteve, diplomimin etj.</p> <p>Aksesi në dokumente dhe informacione garantohej si për personelin dhe studentët në mënyrë fizike dhe virtuale nëpërmjet web, mail, zonës së studentit në website, bazuar dhe në sistemin e përdorimit elektronik.</p>

	<p><i>Ref.2. Statuti I UST-së Kapitulli VI (neni 70.71)</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit</i></p> <p><i>Ref.16.Linku (https://fshl.ust.edu.al/master-i-shkencave/)</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimet e realizuara me stafin, studentët, sekretarinë, GVJ, konstatoi se nëpërmjet këtij sistemi institucioni për mbarëvajtjen e procesit mësimor, bashkëveprimin institucional staf akademik, ndihmës akademik, administratë dhe studentëve, bënte mundur komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve didaktike, publikimin e informacioneve të ndryshme institucionale si: njoftime për pedagogët, apo dhe informacione të ndryshme midis pedagogut dhe studentëve.</p> <p>Sekretaria ka një rol shumë aktiv në krijimin e rritjes së mundësive të studentëve për konsultim dhe komunikim me përgjegjësit e departamenteve dhe drejtuesve të tjerë të fakultetit (dekanë apo zv dekanë). Në takimin me studentët u konfirmuan marrëdhënie të mira dhe të hapura me personalin akademik për probleme të ndryshme të jetës së përditshme studentore.</p> <p><i>Ref.2. Statuti I UST-së Kapitulli VI (neni 70.71)</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit.</i></p> <p><i>Ref.16.Linku (https://fshl.ust.edu.al/master-i-shkencave/)</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e ndryshme të UST, si ajo e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit rezulton se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e zhvillimit të leksioneve dhe aktiviteteve të tjera mësimore. UST disponon dokumentacionin e nevojshëm me informacionet mbi stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm dhe për stafin administrativ.</p> <p>Sistemi i Pitagorës garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale të çdo anëtari të stafit akademik. Sistemi elektronik i informacionit gjithashtu shmang vonesat në informim të</p>

	<p>studentëve për rezultatet e vlerësimit dhe rrit transparencën e mësimdhënies dhe të vlerësimeve përkatëse. Ky sistem me të dhënat e hedhura, gjithashtu ndihmon institucionin për një përpunim statistikor të të dhënave.</p> <p><i>Ref.2 Statuti I UST-së Kapitulli VI (neni 70.)</i> <i>Ref.5. Rregullore e Sekretarisë</i> <i>Ref.16.Linku (https://fshl.ust.edu.al/master-i-shkencave/)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ, gjatë studimit të faqes zyrtare të institucionit konstaton se, institucioni ka në administrim faqen zyrtare www.ust.edu.al.</p> <p>Faqja zyrtare është në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe siguron informacion mbi misionin e institucionit, programet e studimit, stafin akademik, informacione për studentët. Informacion që përmbahet në faqe përcaktohet nga një dokument rregullator specifik.</p> <p>Po në këtë faqe janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendarin akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të fakultetit.</p> <p><i>Ref.16.Linku (https://fshl.ust.edu.al/master-i-shkencave/)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se UST, disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Konstatohet, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të web-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Boto

[Signature]

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ, bazuar në RVB, konstatoi që Institucioni ka hartuar një raport financiar të kostove të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit dhe mbështetjen financiare, sipas Udhëzimit të MASR nr.5, datë 19-2-2018 “Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportit vjetor” i ndryshuar me Udhëzimin e MASR nr.24 datë 21-10-2019</p> <p><i>Ref.2.2.Vendimi I Senatit nr.107 dt.21-12-2022, "Raporti Vjetor për veprimtarinë akademike</i></p> <p><i>Ref.2.3. , "Raporti Vjetor për veprimtarinë akademike, I Bordit të Administrimit.</i></p> <p><i>Ref.17.Financat (Pasqyra Financiare)</i></p>



<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ,bazuar RVB, konstatoi që Institucioni ka hartuar dhe ka vepruar në bazë të Projekt Buxhetit afatmesëm 2024-2026, në të cilin janë parashikuar fondet e nevojshme për mbulimin financiar dhe buxhetor të shpenzimeve operative, shpenzimeve për mirëmbajtjen e mjediseve, mirëmbajtjen e bazës teknologjike, shpenzimet për Bibliotekën Online, detyrimet financiare duke përfshirë këtu edhe grantet e përfituara nga faktorë vendas apo të huaj, të gjitha këto në shërbim të mbarëvajtjes së programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor”</p> <p><i>Ref.45.Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ,bazuar RVB, konstatoi që UST,mbështetur në Statutin, në vendimin e Senatit dhe në vendimin e Bordit të Administrimit, ka realizuar auditim periodik, me anë të të cilit, dokumenton dhe vlerëson gjendjen financiare dhe rrugët e përdorimit të tij.</p> <p><i>Ref.2. Statuti I UST-së (neni42, pika 1,neni 43/germa i.1</i></p> <p><i>Ref.2.2. Vendimi I Senatit nr.107 dt.21-12-2022, ”Raporti Vjetor për veprimtarinë akademike</i></p> <p><i>Ref.2.3. , ”Raporti Vjetor për veprimtarinë akademike, I Bordit të Administrimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit para ardhës.</p>	<p>Konstatohet se UST, mbështetur në Statutin, në vendimin e Senatit dhe në vendimin e Bordit të Administrimit,Institucioni raporton në nivel Njësie Bazë.</p> <p><i>GVJ, sugjeroi, që ndryshe nga praktika e ndjekur deri më sot, fondet duhet t’i shkojnë vetë departamentit dhe të shpenzohen për nevojat e vetë departamentit nga departamenti.</i></p>

	<p>Në këtë mënyrë rritet demokracia në Institucion dhe niveli i përgjegjësise dhe i transparencës financiare është më i dukshëm.</p> <p><i>Ref.2.2. Vendimi i Senatit nr.107 dt.21-12-2022, "Raporti Vjetor për veprimtarinë akademike</i></p> <p><i>Ref.17.Financat (Pasqyra Financiare)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë inspektimit dy ditor në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, konstatoi që UST, mbështetur në Statutin, në vendimin e Senatit, në vendimin e Bordit të Administrimit dhe Ligjin e IAL, (neni 49), ka garantuar financim të qëndrueshëm të programit të studimit dhe rritjen e kuotës së financimit, në ato raste kur ka përmirësim të situatës financiar.</p> <p>Financat e institucionit varen nga buxheti i shtetit por dhe nga të ardhurat dytësore institucionale si, tarifa të ndryshme të studentëve, të cilat ndihmojnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor si dhe në përmirësimin e infrastrukturës institucionale.</p> <p><i>Ref.2. Statuti I UST-së (neni 7, pika 3.</i></p> <p><i>Ref.1 Ligji IAL-së (neni 49)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UST garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i></p> <p><i>GVJ, sugjeroi, që ndryshe nga praktika e ndjekur deri më sot, fondet duhet t'i shkojnë vetë departamentit dhe të shpenzohen për nevojat e vetë departamentit nga departamenti.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit, konstaton që UST, bazuar në rregulloret e brendshme, në statutin dhe Ligjin e IAL, në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka hartuar dhe zbaton procedura të cilat e mbulojnë ciklin e plotë të ecurisë së studentëve, gjatë gjithë ciklit nga hyrja deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Këto parime dhe kritere mbështeten në legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloret përkatëse. Pranimi në këtë program studimi është me numër të caktuar kuotash. Çdo vit senati i UST miraton kuotat e pranimit, kriteret e pranimit, vendet e disponueshme, për të gjitha kategoritë dhe publikohen në faqen e internetit të institucionit. Procedurat e pranimit bëhen të njohura në faqen zyrtare të UST me anë të shpalljeve dhe njoftimeve të pranimit, të cilat përmbajnë informacione të hollësishme për vendet e disponueshme dhe kriteret e pranimit.</p> <p><i>Ref.1. Ligji I IAL (neni 25)</i> <i>Ref.2. Statuti I UST-së (kreu VII)</i> <i>Ref.3 Rregullore e UST, (Programi i Studimit dhe Rregullorja e tyre)</i> <i>Ref.4 Rregullore e FSHL (kreu VI)</i> <i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit (Kreu VI)</i> <i>Ref.6. Rregullore e Programit (MEFSH-B)</i> <i>Ref.31 Rregullore e Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, konstaton që UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka hartuar dhe zbaton procedura</p>

Buto

[Signature]

<p>kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>të cilat që sigurojnë dhe mbrojnë të drejtat e të gjithë studentëve të përfshirë në programin e studimit.</p> <p><i>Ref.1. Ligji I IAL (neni 25)</i> <i>Ref.2. Statuti I UST-së (kreu VII)</i> <i>Ref.3 Rregullore e UST, (Programi i Studimit dhe Rregullorja e tyre)</i> <i>Ref.4 Rregullore e FSHL (kreu VI)</i> <i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit (Kreu VI)</i> <i>Ref.6. Rregullore e Programit (MEFSH-B)</i> <i>Ref.31.Rregullore e Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe të Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, konstatoam që UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka hartuar dhe ka publikuar para vitit akademik, kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve. Ne pamë konkretisht nga zyra e kurrikulave, praktikën shkresore dhe dokumentare, që ndjek Institucioni për këtë qëllim.</p> <p><i>Ref.2. Statuti I UST-së (kreu VII)</i> <i>Ref.4 Rregullore e FSHL (kreu VI)</i> <i>Ref.6. Rregullore e Programit (MEFSH-B)</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, konstatoam që UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka hartuar kritere, procedura të përzgjedhjes së studentëve, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të programit të studimit Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukimin e Shëndetësor", janë të aksesueshme nga të interesuarit, përfshirë edhe publikun e gjere.</p>

Boto



	<i>Ref.16.Linku (https://fshl.ust.edu.al/master-i-shkencave/</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni merr pjesë në fushatat e informimit të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (open day), fletushka të ndryshme, marketing në studio dhe media të ndryshme, duke bërë informimin e publikut dhe të maturantëve të interesuar për diplomat që menaxhon UST-ja, programet, kuotat, kriteret përkatëse, për çdo program studimi, përmes portalit E albania dhe faqes zyrtare të universitetit</p> <p><i>Ref.16.Linku (https://fshl.ust.edu.al/master-i-shkencave/</i> <i>Ref.5.Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetësor</i> <i>Ref.6. Rregullore e Programit MEFSH-B</i></p>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konkludon se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p><i>Rregullore e Universitetit të Sportit të Tiranës (UST)</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (FSSL)</i> <i>Ligji I IAL neni 25</i></p>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>GVJ, mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit konstaton se Institucioni para çdo viti akademik planifikon kuotat, kriteret sipas programit, infrastrukturës së institucionit, nr të stafit akademik pas propozimeve nga dekanati, kalojnë në rektorat dhe miratohen në senat dhe dërgohen për miratim në MAS .</p> <p><i>Ligji I IAL neni 25</i></p>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Referuar RVB, institucioni bazohet në udhëzimet dhe vendimet e qeverisë për politikën e ndihmës/bursave për shtresa në nevojë. Ky institucion bën publike në faqen web të institucionit kriteret dhe sqarime të tjera për përfituesit e bursave, referuar vendimeve dhe udhëzimeve të qeverisë, si dhe mënyrës së administrimit të tyre.</p>

	<p><i>Ref.1. Ligji I IAL-së (neni 112)</i></p> <p><i>Ref.2.1. Plani Strategjik I UST-së(prioriteti strategjik 2:objektivi 3)</i></p> <p><i>Ref.17.1. Tarifa e Studimit (Bordi Administrativ)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron institucioni, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online ne faqen zyrtare të web-it.</i></p> <p><i>Gjithashtu, konstatojmë se institucioni, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentët si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V. 2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Gjatë inspektimit dy ditor në mjediset e UST-së, GVJ konstatoi se UST, mbështetur në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka vënë në shërbim të studentëve, informacion të mjaftueshëm, që lidhet me kriteret e konkurrimit, detyrimet studentore, ecurinë e procesit akademik në vijimësi dhe gjatë kapërcimit nga një vit akademik në vitin pasardhës. Këto kriteret dhe procedura janë pjesë e Rregullores së UST, rregullores së Fakultetit dhe veçanërisht të Rregullores së programit të studimit. Rregullore e UST është e publikuar në faqen zyrtare web të institucionit.</p> <p><i>Ref. 2. Rregullore e UST-së (Procedurat e vlerësimit të studentëve)</i></p>

	<p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit(Kreu III)</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit (Kreu III)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se UST, mbështetur në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka vënë në shërbim të studentëve, informacion të mjaftueshëm, që lidhet me kriteret dhe procedurat ligjore që ndjek Institucioni, për njohjen e kualifikimeve të mëparshme si dhe studimeve të pjesshme, kur këto raste ndeshen në praktikë.</p> <p>Institucioni për të bërë të mundur ekuivalentimin e programeve të studimeve për studentët që duan të transferojnë studimet në UST, ngre një komision i cili bën ekuivalentimin e lëndëve bazuar në programin e studimit “Mësuesi në edukim fizik e shëndetësor” në UST. Studenti i cili dëshiron të transferojë studimet në UST, informohet për të gjitha procedurat, kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve, ekuivalentimin dhe vitin në të cilin ky student i transferohen studimet.</p> <p><i>Ref.1. Ligji I arsimit të Lartë (Neni 76, pika 5)</i></p> <p><i>Ref.2. Statuti I UST-së(Neni 7, pika 4)</i></p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së (Neni 60, pika 4, neni 106)</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore e FSHL-së (Neni 72)</i></p>
<p>3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konkludoi që studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet Rregullores së UST-së, rregullores së programit etj.</p> <p>Sipas <i>nenit 81</i> të rregullores së UST, parashikohen instrumentet e vlerësimit ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e gojë, punëve në grup projekte dhe teza diplome; - kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formuese të kompetencave profesionale të programit nga studenti; - metodat e vlerësimit janë strategjitet, teknikat mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit në të cilin studentit demonstroi përvetësimin e objektivave formuese të kompetencave profesionale të programit;

	<p>Gjithashtu në orën e parë të fillimit të procesit mësimor për secilën lëndë, studentëve ju ofrohet informacion nga pedagogu për syllabusin e lëndës, detyrimeve për tu përmbushur si edhe mënyrën e vlerësimit.</p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së (Neni 81)</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore e FSHL-së (Neni 80,81,82)</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e Program Studimi Master i Shkencave “Edukim Fizik dhe Shëndetësor) Neni 12.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, rregullores së diplomimit të UST-së, rregullores së programit të studimit dhe vizitës në institucion, GVJ konkludoi që studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e diplomimit për këtë program studimi. Procedura e mbrojtjes së diplomës, për studentët e programit Master i Shkencave në Mësuesi në edukimin fizik e shëndetësor është vetëm me mbrojtje tezë diplome. Drejtuesit e tezave të diplomës propozohen nga njësia bazë dhe aprovohen nga drejtuesi i njësisë kryesore.</p> <p>Tema e diplomës duhet të përkojë me fushat e kërkimit të departamentit. Studenti, ka të drejtë të paraqitet në mbrojtjen e tezës së diplomës vetëm pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademik-administrative me UST-në. <i>(neni 4 rregullore e diplomimit)</i></p> <p>Referuar takimit me studentët gjatë vizitës në institucion, studentët ishin të mirinformuar për mënyrën dhe procedurat e diplomimit, gjatë viteve të studimeve. GVJ, la porosi që procedurat e punimit të temës së diplomës, të nisin më herët se deri më tani dhe mori mirëkuptimin e stafit.</p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së (Neni 107)</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore e FSHL-së (Neni 70)</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e Program Studimi Master i Shkencave “Edukim Fizik dhe Shëndetësor) Neni 18,20.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë</p>	<p>Gjatë vizitave në institucion GVJ konstatoi se UST ka strukturë (Drejtoria juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) që merret me gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet</p>

<p>publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>e studimit. Takimet janë të organizuara (open day) dhe marrin pjesë pedagogët e njësisë bazë, anëtarë të personelit akademik, të cilët organizojnë takime periodike me nxënësit e shkollave të mesme. Përgjatë ditëve të regjistrimit, njësia kryesore vë në dispozicion të studentëve të interesuar për të vazhduar studimet në programin e studimit Bachelor, grupe pedagogësh që japin informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve në UST dhe nga UST tek universitetet me programe të ngjashme brenda dhe jashtë shtetit.</p> <p><i>Ref.2. Statuti i UST-së (Kreu VI, neni 70 dhe neni 75)</i> <i>Ref 3. Rregullore e Universitetit të Sportit të Tiranës (UST)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre, transferimit të studimeve si dhe njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh.</i></p> <p><i>Institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit, praktikës profesionale, si dhe përmbylljes së tyre me tezë diplome.</i></p> <p><i>Nëpërmjet Rregullores së UST dhe Guidës së studentëve, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe diplomimi, kriteret e aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UST dhe funksionet e tyre, si dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të tyre</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB, vizitës në institucion, si dhe faqes web të UST, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Edukim fizik e shëndetësor informohen në fillim të studimeve nga pedagogët që janë të angazhuar në këtë program studimi, si dhe sekretaria mësimore e Fakultetit për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. Informacion ofrohet edhe në faqen web të UST si edhe në rrjetet sociale, që administrohen nga njësia bazë.</p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së (Neni 59)</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore e FSHL-së (Neni 68)</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e Program Studimi Master i Shkencave "Edukim Fizik dhe Shëndetësor) Neni 2,3,4.</i></p> <p><i>Ref.7. Plani Mësimor i Programit të Studimit (MEFSH-B)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët e këtij program studimi marrin informacion më të detajuar për të gjithë elementët lidhur me modulet e kurrikulës së programit, gjatë prezantimit të orës së parë të mësimit nga pedagogët e lëndës. Informacion të detajuar studentët mund të gjejnë edhe në: sekretarinë mësimore, faqen ueb të UST-së, afishimeve në ambientet e Fakultetit, rrjeteve sociale, si edhe komunikimit me pedagogët e angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><i>Ref.2. Statuti I UST-së (kapitulli VI)</i></p> <p><i>Ref.3. Rregullore e UST-së (Neni 32 pika h/i)</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore e FSHL-së (Neni 11, pika 3, a,m,o,p, neni 19, pika i, neni 115)</i></p> <p><i>Ref.6. Rregullore e Program Studimi Master i Shkencave "Edukim Fizik dhe Shëndetësor) Neni 2,3,4.</i></p> <p><i>Ref.25. Programi i Lëndës/moduli shqip</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, dhe gjatë takimeve në institucion, konstaton se UST, informon studentët në mënyrë të vazhdueshme për tregun e punës dhe kriteret e tij. Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës, si në rang universiteti nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit,</p>

B. G. G.

[Signature]

	<p>Marrëdhëniet me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni, ashtu si edhe Zyra e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI janë dy zyra të institucionit të cilat u japin studentëve informacione mbi mundësinë e punësimit. Nëpërmjet organizimit të praktikave mësimore në institucionet partnere, studentëve me performancën më të mirë u ofrohet mundësi punësimi reale ose projektet bashkëpunuese me UST. Përmes aktiviteteve të vazhdueshme të sektorit të alumnit, studentët kanë mundësi të marrin informacione dhe orientim mbi tregun e punës.</p> <p><i>Ref.1. Ligji IAL-së(Neni 103, pika 4)</i> <i>Ref.2.1. Plani Strategjik I UST-Së</i> <i>Ref.24.Alumni</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se, pedagogët e departamentit, në javën e parë të fillimit të studimeve, pedagogët e angazhuar në këtë program studimi në orën e parë të fillimit të lëndës së tyre, sekretaria mësimore, si dhe në mënyrë më të dedikuar Koordinatori për programin e studimit, luajnë një rol kyç në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Faqja ueb e UST-së si dhe rrjetet sociale luajnë gjithashtu një rol thelbësor në ofrimin dhe përditësimin e informacionit në lidhje me elementë të rëndësishëm të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga takimi me studentët u konstatua se UST vë në dispozicion të studentëve informacionin, dokumentacionin dhe udhëzues të posaçëm për lëndët dhe veprimtarinë formuese të cilat shprehen qartë dhe në syllabuset e lëndëve të programit. Studenti i akseson të dhënat nëpërmjet llogarisë personale (portali i studentit) në platformën Pitagora, që ata marrin në momentin e regjistrimit në UST nga Zyra e IT, nga ku nga ku kanë të drejtë të futen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit. Edhe në distancë, on-line përmes platformës studentët mund të shohin të dhënat në lidhje me programin e studimit, si edhe të komunikojnë me mesazhe me pedagogët e lëndëve dhe moduleve.</p>

Beto

[Signature]

	<i>Vizita në institucion;</i>			
Konkluzione	<p><i>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i evidencave, konstatohet që UST publikon një informacion të plotë për strukturat e UST –së dhe funksionet e tyre, departamentet e ndryshme, auditorët, sekretaritë mësimore, bibliotekën, laboratorët, sistemin elektronik, etj. Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme pedagogjike që institucioni organizon.</i></p> <p><i>Rezulton se në çdo fillim të vitit akademik studentëve u prezantohen materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Msc në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor”, ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe diplomimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Sekretaria mësimore pranë UST-së është njësia që kujdeset për mbajtjen e të dhënave dhe përpunimin statistikor vjetor për numrin e studentëve e të diplomuarve, në të gjithë programet e studimit të ofruar nga institucioni. Pranë sekretarisë ne u informuam për ecurinë vjetore të studentëve nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve, të dokumentuara edhe fizikisht (regjistra) dhe elektronikisht.</p> <p><i>Ref.13.(Sekretaria, Rregullore e funksionimit të brendshëm të sekretarisë mësimore)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të	Sekretaria mësimore e Fakultetit mbledh, regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të

regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

studimeve dhe diplomimin e tyre. Regjistrat në sekretari (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i lëshimit të diplomave) janë të formatuar sipas standardeve shtetërore. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në mësuesi në edukim fizik e shëndetësor dhe konstatoi plotësinë e tyre. Të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi janë:

Viti akademik	Të regjistruar	Të çregjistruar	Totali
2022 - 2023	188	5	183
2023 - 2024	196	0	196
2024 - 2025	219	0	219
	603	5	598

Ref.13. (Sekretaria, Rregullore e funksionimit të brendshëm të sekretarisë mësimore)

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

GVJ gjatë vizitës në institucion, RVB, referencave përkatëse konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga sekretaria mësimore. Çdo student ka dosjen e tij, e cila na u vendos në dispozicion ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. GVJ konstatoi se këto të dhëna janë të disponueshme në sekretarinë mësimore, në formë shkresore dhe në sistemin Pitagora, të cilat janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave.

Ref.13. (Sekretaria, Rregullore e funksionimit të brendshëm të sekretarisë mësimore)

*Ref.40. Marrëveshja RASH/Pitagora
(<https://ust.pitagora.rash.al/login>)*

Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin


Konstatohet se UST bën kontrole periodike për procesin mësimor, kontrole periodike ose audit të brendshëm, harton raporte periodike mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar

Quto

[Signature]

<p>(sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Në fund të vitit kalendarik departamenti përgjegjës për programin e studimit analizon dhe harton një raport analitik mbi arritjen e objektivave formuese të programeve të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen.</p> <p><i>Ref.8 Rregullore e Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Ref.8.1. N.J.S.B.C.</i> <i>Analiza Vjetore e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit 2022-2023</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ bazuar në vizitën në institucion dhe në veçanti takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës, konstaton re se institucioni i kushton një rëndësi të veçantë mbledhjes së të dhënave të studentëve të diplomuar (edhe pse për këtë program akoma nuk janë diplomuar). Këto të dhëna jepen në formë statistikore edhe në raportet vjetore që hartohen nga institucioni.</p> <p><i>Ref.6. Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Ref.35. Analiza Vjetore e Departamentit</i> <i>Ref.24.Alumni</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita dhe takimet në institucion, si dhe nga evidencat e shqyrtuara konstatohet që institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalje.</i></p> <p><i>Gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themeltar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatorë të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e institucionit të UST, statutin e institucionit, takimit me grupin e studentëve, konstaton se në të gjitha organet kolegjiale të UST, vërehet prania e përfaqësuesve të studentëve sipas rregulloreve të UST dhe Ligjit të Arsimit të Lartë. Gjithashtu në UST është i ngritur dhe funksionon edhe Këshilli Studentor i cili organizohet në nivel njësie kryesore dhe kryen aktivitetin në bazë të statutit të tij dhe koordinon përfaqësimin e studentëve në të gjitha organet kolegjiale ku ata janë të përfshirë. Organet kolegjiale të UST ku studentët janë të pranishëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Këshilli i Studentëve në rang njësie kryesore dhe universiteti; - Senati Akademi; - Këshilli Etikës; - NJSBC; <p><i>Ref.2. Statuti UST-së (Kreu IX, neni 02,pika 1.2:neni 95</i> <i>Ref.4. Rregullore e FSHL-së (neni 110/pika b)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Bazuar në statutin e UST <i>neni 95</i>, takimin me studentët konstaton se,studentët janë të përfshirë në organet kolegjiale si më poshtë, ashtu siç referuam edhe në kriterin e mësipërm (kriteri 1): Senati akademik; Këshilli i etikës; Komisionet e përhershme të lejuara me statut; Këshillat e studentëve;</p> <p>Gjithashtu, institucioni, përmes anketimeve, vlerësimeve periodike të studentëve për pedagogët(pyetësor anonim), lëndët dhe institucionin, mbledh dhe përpunon të dhëna të cilat përdoren nga organet vendimmarrëse për menaxhimin e vet institucionit. Të dhënat e mbledhura diskutohen në nivel institucional, me qëllim evidentimin e situatave dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm të problematikave të dala(nuk kishin ndonjë problematik të evidentuar apo të dokumentuar).</p>

	<p><i>Ref.37. Rregullore e marrëdhënies me studentët.</i></p> <p><i>Ref.37.1. Vendimin e KIZ mbi zgjedhjet studentore</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes një pyetësorit anonim me studentët dhe përmes fokus grupeve. Pyetësori organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit. Ndër rubrikat e pyetësorit është që të vlerësohet edhe sylabusi i lëndës. Takimet këshilluese të studentëve me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, në disa raste edhe në praninë e koordinatorit të programit. Gjetjet e tyre, bëhen pjesë e diskutimeve, raporteve analitike semestrale e vjetore, dhe mund të shoqërohen me ndryshime në programin e studimit.</p> <p><i>Rekomandohet që të punohet më shumë për organizimin e studentëve në klube dhe shoqata studentore ku ata të mund të ndajnë në mënyrë intelektuale kohën e lirë të tyre.</i></p> <p><i>Ref.5. Rregullore e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Shëndetit (neni 12)</i></p> <p><i>Ref.4. Rregullore e FSHL-së (Kreu IX)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të vlerësimit të studentëve dhe pasqyrohet në programin apo sylabusin e secilës lëndë.</p> <p>Pedagogu i lëndës përgatit tezat e provimit paraprakisht, miratohet nga shefi i departamentit dhe në provim tezat janë të sekretuara. Pedagogu ndërkohë ju ka bërë paraprakisht me dije studentëve vlerësimin e provimit të ndërmjetëm si shpjegimet për vlerësimin aktual, mundësinë e rishikimit të tezës dhe çelësit të përgjigjeve, dhe mundësia për rivlerësim nga një komision i posaçëm nëse ka ankimime ndaj vlerësimit të pedagogut. Të gjitha këto elemente të vlerësimit të studentit janë të parashikuara në rregulloret e UST dhe janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashitrojnë kërkesat e tyre duke ndjekur procedurat e parashikuara në rregulloren e institucionit. Gjatë takimit me studentët një student shprehu pakënaqësi për</p>

	<p>saktësinë e vlerësimit, nga një pedagog, por nuk kishte ndjekur rrugën e ankimimit, parashikuar në rregullore, për arsye që nuk i cilësoi. Sigurisht, ky ishte vetëm një rast dhe nuk prek punën e mirë që bën njësia bazë, për barazinë dhe meritokracinë në vlerësim.</p> <p><i>Ref.4. Rregullore e FSHL-së (neni 90)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në takimet në institucion dhe shqyrtimi i evidencave, konstatohet që studentët e UST janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillime dhe vlerësime mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Bordin Administrativ dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm. Studentët kanë krijuar një numër të madh grupesh shoqërore për të menaxhuar më mirë jetën e tyre sociale dhe për të përmirësuar marrëdhëniet me njëri tjetrin. Atyre u është dhënë mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana e pedagogëve të çdo lënde.</i></p> <p><i>Rekomandohet që të punohet më shumë për organizimin e studentëve në klube dhe shoqata studentore ku ata të mund të ndajnë në mënyrë intelektuale kohën e lirë të tyre</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet	Në Statutin dhe rregulloret e UST-së, si dhe në rregulloren e programit të studimit përcaktohen procedurat dhe njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve. Informimi i studentëve nga stafí, sekretaria bëhet që në ditët e informimit (open day) për të zgjedhur këtë universitet, po ashtu të drejtën e informimit studentët e marrin fizikisht në institucion

<p>ligjore dhe aktet rregullatorë të institucionit.</p>	<p>te sekretaria, drejtuesit e institucionit, me anë të posterave të afishuara në vende të dukshme të institucionit, apo në distancë nëpërmjet informimit on line me anë të sistemit të Pitagorës.</p> <p>GVJ, pa konkretisht dokumentacionin, ku pasqyrohet drejtë dhe saktë kjo praktik, në shërbim të informimit të studentëve, në mënyrë institucionale dhe pa pengesa.</p> <p><i>Ref.24.Alumni (https://alumni.ust.edu.al/)</i></p> <p><i>Ref.37. Rregullore për organizimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhëniet me studentët (MVMS)</i></p> <p><i>Ref.42. Vendimi nr.67, datë 23-04-2021 "Për miratimin e rregullores se organizimit dhe funksionimit të administratës së UST-Së (neni 5, pika b).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Mbështetur te Statuti UST-së dhe posaçërisht te Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të Administratës, si dhe Rregullore për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, ka hartuar procedura si dhe ka ngritur njësi të posaçme që shërbejnë për informimin e studentëve sipas kërkesave të ligjit. Një rol të qenësishëm luan pa dyshim, Sektori i Këshillimit të karrierës dhe Linku i Alumnit, Websiti UST-së, nëpërmjet llogarive personale të studentëve, etj.</p> <p>GVJ, pa konkretisht dokumentacionin, ku pasqyrohet drejtë dhe saktë kjo praktik, në shërbim të informimit dhe këshillimit të studentëve të Programit të Studimit, Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetsor"ë asistimin e tyre përgjatë gjithë procesit mësimor akademik, në mënyrë institucionale dhe pa pengesa burokratike.</p> <p><i>Ref.16. Linku</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me</p>	<p>UST u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Studentëve u ofrohet këshillimi i karrierës, me anë të disa zyrave dhe drejtorive si, zyra e këshillimit të karrierës, drejtoria e koordinimit, marrëdhënieve me jashtë, ALUMNI. Këto zyra janë në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me, aktivitete të ndryshme studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, projekte të ndryshme, mundësi punësimi duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Gjithashtu UST ka krijuar kontakte me</p>

Beta



<p>kompletimin e procesit mësues, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/inter-shipeve të studentëve, por edhe të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p> <p><i>Ref.241.. Linku I ALUMNIT (https://alumni.ust.edu.al/)</i></p> <p><i>Ref.42. Vendimi nr.67, datë 23-04-2021 "Për miratimin e rregullores se organizimit dhe funksionimit të administratës së UST-Së (neni 5, pika b).</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se UST ka një sistem të mirë organizuar për informimin, këshillimin e studentëve dhe ka disa zyra dhe drejtori të cilat ndjekin në mënyrë periodike studentët jo vetëm gjatë viteve akademike, por edhe pas punësimit të tyre. Drejtoritë dhe zyrat përkatëse si, Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhënive me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI mban kontakte për pjesëmarrje në trajnime pasuniversitare brenda apo jashtë vendit si dhe mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UST.</p> <p>Referuar të dhënave të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, rezulton që për vitin akademik 2021-2022, nga 131 studentë të diplomuar në Programin e Studimit, Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor", 72 studentë janë punësuar brenda titullit të diplomës dhe vetëm 32 prej tyre janë të punësuar në punë jashtë titullit të diplomës. Zyra e Këshillimit të Karrierës e UST-së, ruan marrëdhënie të vazhdueshme dhe ndjek me korrektësi, ecurinë e karrierës edhe për studentët që lëvizin jashtë Shqipërisë.</p> <p><i>Ref.24. Linku</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion, takimet me studentët dhe shqyrtimi i evidencave, konstatohet se studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, përfshirjen në lëndët që duhet të japin provim.</i></p> <p><i>Gjithashtu, konstatohet se nëpërmjet Njësise së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, projekteve, seminareve, takimeve</i></p>

	<i>informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktiviteteve të ndryshme që institucioni organizon. Institucioni gjurmon edhe punësimet e studentëve pas diplomimit për t'i paraqitur në statistikat dhe raportet e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI. 1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>UST, ka të ngritur dhe funksional, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC vlerëson në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike funksionalitetin, efikasitetin dhe produktivitetin e stafit të IAL në lidhje me veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore nëpërmjet pyetësorëve anonim dy herë në vit që ju bëhen studentëve mbi aktivitetin mësimor, aktivitetin shkencor, infrastrukturën e institucionit, komunikimin me sekretarinë, administratën etj.</p> <p>NJSBC ka të drejtë të ketë akses dhe të kontrollojë në të gjitha materialet dhe të dhënat e institucionit në bazë të plani strategjik të zhvillimit të UST. Përdorimi i Sistemit të Pitagorës që aplikohet, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore duke vënë në dispozicion metoda kreative jo vetëm në auditor por dhe</p>

	<p>në distancë për tematika të ndryshme mësimore, laboratorë, detyra kursi etj.</p> <p><i>Ref.2.1. Plani Strategjik I Zhvillimit të UST-së2021-2026, prioriteti strategjik 2, objektivi 1 dhe 2.</i></p> <p><i>Ref 8.1 Rregullore për Sigurinë e Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBC pranë UST-së mbështetur në rregulloren për këtë njësi synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standardet e cilësisë të përcaktuar nga UST, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm.</p> <p>NJSBC ka ndryshuar strukturën e saj bazuar dhe në ligjshmërinë aktuale, rregulloret e funksionimit, Statutin e UST, duke bërë pjesë të NJSBC, përfaqësues nga të gjitha njësitë bazë (përfshirë këtu edhe FSHL), 1 përfaqësues nga studentët.</p> <p><i>Ref.8.1. Rregullore për sigurimin e cilësisë(neni 3-Fusha e Veprimtari: "Menaxhimi i cilësisë, rritja e cilësisë, kontrolli i cilësisë dhe vlerësimi i cilësisë, janë mjetet nëpërmjet të cilave sigurohet cilësia" Neni 7. Veprimtari monitorimi, vlerësimi dhe përmirësim)</i></p> <p><i>Ref.2.1. Plani Strategjik I Zhvillimit të UST-së2021-2026, prioriteti strategjik 2, objektivi 1 dhe 2.</i></p> <p><i>Ref 8.1 Rregullore për Sigurinë e Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në takimin e realizuar me studentët GVJ konfirmoi se UST garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies. Studentët referojnë se gjatë viteve akademike, ata në formë elektronike plotësojnë një pyetësor anonim dy herë në vit (çdo semestër) para sezonit.</p> <p>GVJ, konstatoi që Institucioni, bazuar në Planin Strategjik të UST-së dhe në akte të tjera ligjore dhe nën ligjore, ka zhvilluar mekanizma ku sigurohet informacion periodik, nga Fokus Grupet dhe NJSBC-të, për cilësinë e procesit mësimor, metodat innovative etj, që së bashku me qeverinë studentore,</p>

	<p>kontribuojnë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Vendosija e studentit në qendër, marrja mendimit të tyre nëpërmjet Pyetësorit të Studentit, dhe formave alternative, shprehja e mendimit të tyre për performancën e pedagogut, etikën, komunikimin, seriozitetin dhe novacionin, vlerësim ku përfshihen gjithë pedagogët nxit rritjen e cilësisë dhe motivon studentët të përshihen në procesin e përmirësimit të cilësisë, si faktor që prodhon zgjidhje dhe ka fuqi ndryshimi dhe vendimmarrjeje.</p> <p><i>Ref.2.1. Plani Strategjik I Zhvillimit të UST-së 2021-2026, prioriteti strategjik 2, objektivi 3</i></p> <p><i>Ref.8. Manual I NJSBC, neni 6</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>UST, bazuar në Planin Strategjik dhe në akte të tjera ligjore dhe nën ligjore, ka zhvilluar mekanizma ku sigurohet informacion periodik, nga Fokus Grupet dhe NJSBC-të, për cilësinë e procesit mësimor, metodat inovative etj, që së bashku me qeverinë studentore, kontribuojnë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Vendosija e studentit në qendër, marrja mendimit të tyre nëpërmjet Pyetësorit të Studentit, dhe formave alternative, shprehja e mendimit të tyre për performancën e pedagogut, etikën, komunikimin, seriozitetin dhe inovacionin, vlerësim ku përfshihen gjithë pedagogët. Mbështetur në Ligjin 80/2015, NJSBC organizon formularët e vlerësimit, rezultatet e të cilit janë bërë publike në mënyrë periodike, si dhe promovohen shembujt e praktikave më të mira, që rrisin besueshmërinë dhe orientojnë studentët drejt modeleve ekselente dhe meritokracisë që buron nga aftësia dhe puna në rritje.</p> <p><i>Ref.8.1. Rregullore për sigurimin e cilësisë (neni 7, pika 2a, b)</i></p> <p><i>Ref.2.1. Plani Strategjik I UST-së (Prioriteti Strategjik 2-Objektivi 2-Përsosmëri në mësimdhënie dhe të nxëniet)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt e praktikave të mira, nxit personelin akademik për</p>	<p>Referuar vizitës në Institucion, në takim me stafin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi gatishmërinë e Institucionit për mbështetje për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesëmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështetja financiare për të botuar</p>

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>artikuj në revista me faktor të lartë impakti- Scopus, monografi dhe botime të ngjashme shkencore).</p> <p><i>GVJ rekomandon që të zhvillohen analiza dhe mësim të hapura në bazë të përvojave që lektorët e Departamentit fitojnë në vizitat apo bashkëpunimet e tyre me kolegët dhe universitetet e huaja me të cilat kanë bashkëpunime.</i></p> <p><i>Ref.8.1.Rregullore për sigurimin e cilësisë(neni 7,pika 2a,b)</i></p> <p><i>Ref.2.1. Plani Strategjik I UST-së (Prioriteti Strategjik 2-Objektivi 2-Përsosmëri në mësimdhënie dhe të nxënit</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni ka ngritur Komisionin e Përherëshëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në Universitet dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</i></p> <p><i>Takimet me përfaqësues të njësive të ndryshme, por edhe mjaft evidenca flasin për zbatim të udhëzimeve të MAS në lidhje me këtë standard.</i></p> <p><i>Rekomandohet që të zhvillohen analiza dhe mësim të hapura në bazë të përvojave që lektorët e Departamentit fitojnë në vizitat apo bashkëpunimet e tyre me kolegët dhe universitetet e huaja me të cilat kanë bashkëpunime.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI. 2


Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të	GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

<p>Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatorë institucionale.</p>	<p>(NJSBC), e cila ka filluar të funksionoj që në mars 2018, dhe është riorganizuar nga ana strukturale, për sa i përket anëtarëve të NJSBC në vitin 2021. NJSBC është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit.</p> <p><i>Ref.8. NJSBC (neni 2)</i> <i>Ref.8.1.Rregullore për sigurimin e cilësisë (Kreu II, Neni 5,6.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, i cili përgjigjet për zbatimin me sukses të programit të Studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor” dhe vetë Departamenti, kanë hartuar rregullore dhe manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Ligji për Arsimin e Lartë, përcakton krijimin e Njësia e Sigurimit e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme, cilësinë e kërkesave akademike e shkencore. Misioni kryesor i NJSBC-së, është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UST-së, Fakulteteve dhe Departamenteve.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së personelit është siguruar nëpërmjet politikave të rekrutimit, ndërsa vlerësimi i cilësisë së studentëve, është arritur përmes kriterëve të pranimit. Përmes planit strategjik të kërkimit shkencor, është arritur vlerësimi I cilësisë së kërkimit shkencor.</p> <p><i>Ref.2.Plani Strategjik I UST-së (Prioriteti strategjik 6-Sigurimi i cilësisë-Objektivi 2)</i> <i>Ref.8.NJSBC (Manuali i sigurimit të cilësisë, Pjesa e dytë, neni 3)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të</p>	<p>UST ka realizuar dy procese vlerësimi të jashtëm në kuadër të akreditimit Institucional pranë ASCAL. Vlerësimi i parë u bë në vitin 2017, ku UST u akreditua për 3 vite akademike, me vendim të Bordit të Akreditimit nr.64, datë 21.09.2017. Vlerësimi i dytë u bë në vitin 2022, ku UST u akreditua për 6 vite akademike, me vendim të Bordit të Akreditimit nr.02, datë 07.01.2022.</p> <p>Aktualisht UST është duke realizuar procesin e vlerësimit të jashtëm për programet të studimit, duke përfshirë edhe</p>

<p>akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>programin e studimit Master i Shkencave në Mësuesi në edukim fizik e shëndetësor.</p> <p><i>Ref.8. NJSBC ("Manuali I NJSBC-së" Pjesa e dytë, Neni 5/Standardi 10:neni 6, neni 11.)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ referuar dokumenteve të dorëzuara dhe vizitës në Institucion, konkludon që NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues sasior dhe cilësor në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitur iu dërgohen të gjithë strukturave sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe në veçanti Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor.</p> <p>NJSBC, përmes sistemit të saj të informacionit, ka mbledhur dhe mbajtur të dhëna të siguruara nga UST, nga njësitë kryesore si dhe nga koordinatorët e programit të studimit dhe, mbi bazën e tyre, bëhen promovime nxitëse, për arritje edhe më të mira në programin e studimit. Njëherazi, përcaktimi i një grupi kyç përfitimi (TKP), i kanë shërbyer po ashtu, këtij qëllimi madhor.</p> <p><i>Ref.8. NJSBC ("Manuali I NJSBC-së", pjesa 5, neni 15, neni 16.)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat dhe takimet e zhvilluara në Departament, konstatojmë se aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve, si dhe sektorëve kryesorë të saj si Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, qendra këto që kanë një aktivitet të gjerë dhe efektiv.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI. 3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në UST aktiviteti i NJSBC-së ka një sistem raportimi vjetor dhe kryesisht në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si dhe kurrikulën e çdo programi studimi. Ky raport vjetor i monitoruar dhe përpiluar nga NJSBC i paraqitet drejtuesit të njësisë kryesore dhe prezantohet më pas në senatin e Institucionit.</p> <p>UST, bazuar në Planin Strategjik dhe në akte të tjera ligjore dhe nën ligjore, ka zhvilluar mekanizma formale si TKP (Treguesi Kyç i Performancës),</p> <p>TKP, vepron si instrument, për analizimin e arritjeve në rang institucional. Lista e TKP-së mundësohet dhe rifreskohet periodikisht në vijimësi nga NJSBC-ja, dhe më pas i dërgohet për miratim, Komisionit të Përhershëm, Rektoratit dhe Senatit.</p> <p>Nj.S.B.C-ja, e cila grumbullon të dhëna statistikore si</p> <ul style="list-style-type: none"> - ecuria e studentit dhe niveli i suksesit; - raporti pedagog –student; - kostot e burimeve të mësimdhënies; - numri i stafit dhe i studentëve që kërkojnë largim, etj, i përdor ato në shërbim të përmirësimit të punëve në Institucion; <p><i>Ref.8.Rregullore e Sigurimit të Cilësisë (Kreu VI, neni 27)</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga</p>	<p>Rezulton se në mbledhjet e departamentit në fund të çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve, pyetësorët për personelin akademik dhe joakademik si dhe formularët e vetëvlerësimit. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të UST-së sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Mbështetur në analizën vjetore të njësive bazë, përgatitet edhe raporti i analizës vjetore për njësitë kryesore. Në këtë raport vjetor të vetëvlerësimit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, përcaktohen qartë objektivat kryesore në lidhje me procesin mësimor, kualifikimin shkencor dhe</p>


<p>personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>ndërkombëtarizimin. Ky raport përmban informacion të gjerë sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesin mësimor, vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, të cilësisë të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor, si dhe rekomandime e sugjerime për të ardhmen.</p> <p><i>Ref.81..Rregullore e Sigurimit të Cilësisë (Kreu III, neni 16)</i> <i>Ref. 8. NJSBC, "Manuali i NJSBC-së"(Pjesa e IV, neni 12, neni 13, neni 14.)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në takimet me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë që mbulon këtë program studimi, GVJ konstatoi se përdoren disa procedura periodike për vlerësimin e realizimit, të mbarëvajtjes dhe të cilësisë së programit të studimit në nivel Institucioni.</p> <p>U konstatua që Institucioni, bazuar në Programin e studimit, në Manualin e NJSBC-së, në rregulloren e sigurimit të cilësisë dhe materialin përmbajtësor të përfutur nga pyetësorët, ka përdorur forma e metoda të drejtpërdrejta, për të matur dhe vlerësuar nivelin e cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet vëzhgimeve në auditorë, përdorimi i formave krahasuese të rezultateve të provimeve, vëzhgimet në auditor apo mjediset sportive apo në laboratorë, nëpërmjet detyrave të kursit, nëpërmjet testimeve, rezultatet e provimit të shtetit etj. Në takimin më stafin e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, mësuam se përdoret me sukses, këmbimi i përvojës mes pedagogëve dhe shmangja sa më shumë e mbi vendosjes së informacionit nga programi i studimit.</p> <p><i>Ref.7. Programi i studimit(MEFSSH-B, neni 12)</i> <i>Ref.8.NJSBC, (Manuali i NJSBC-së, Pjesa e dytë, neni 6)</i> <i>Ref.8.1.Rregullore e sigurimit të cilësisë (Kreu dy, neni 7)</i> <i>Ref.8.2.Pyetësorët</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e</p>	<p>UST, ka zhvilluar auditim të brendshëm periodik të institucionit me anë të pyetësorëve anketues me studentë me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të studentëve në programe specifike. Metodatat e përdorura përfshijnë: Sondazhe të fokus grupeve të studentëve që ndjekin programet e studimeve, vlerësimi me anë të pyetësorëve anonim të didaktikës mësimdhënëse, kurrikulës etj.</p>

<p>intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Metoda të vlerësimit për stafin akademik janë zhvilluar kontrolle të ndryshme në mënyrë periodike dhe sistematike nga eprori përgjegjësi njësisë bazë, observim i një ore mësimore në auditor. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës vjetore të çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, gjatë shqyrtimit të performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p><i>Ref.8.1.Rregullore e sigurimit të cilësisë (Kreu dy, neni 7)</i> <i>Ref.8.2.Pyetesorët</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në takimet me grupe dhe individë, por edhe nga evidencat, konstatojmë se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve vjetore, si dhe përdor metoda dhe instrumente të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. .</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për</p>	<p>Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë konform legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse. Struktura më e aktive në këtë proces është NJSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe veçanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e cilësisë se UST-së, si dhe</p>

<p>sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Strukturat e sigurimit të cilësisë kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Referuar rregullores së UST-së në këto struktura përfshihen personel akademik efektiv, personel ndihmës akademik, si dhe studentë. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UST-së, në NJSBC, si dhe në hartimin e RVB për vlerësim të jashtëm pranë ASCAL.</p> <p>Institucioni, bazuar në manualin e NJSBC-së dhe sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC), i është përmbajtur rigorozisht Standardeve Evropiane për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Zbatimi në terren i 10 standardeve të përcaktuara, përbën sukses për angazhimin e faktorëve të brendshëm, por edhe e faktorëve të jashtëm, periodikisht.</p> <p><i>Ref.8.NJSBC, (Manuali i NJSBC-së, Pjesa e dytë, neni 5)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në Manualin e NJCBS-së dhe sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC), janë përcaktuar detyra konkrete për gjithë hallkat përgjegjëse të UST-së si:</p> <p>Senatin e UST-së,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë; - Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC); - Koordinatorin Institucional pranë ASCAL/(KIAL); - Sektori i Kurrikulës; <p>Personat përgjegjës për përmbushjen e këtij standardi, në tërësi i kanë përmbushur objektivat e standardeve të përcaktuara si përgjegjësi nga UST-ja.</p> <p><i>Ref.8.NJSBC, (Manuali i NJSBC-së, Pjesa e parë, neni 2)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik,</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, me drejtues, stafin akademik, studentët konstaton gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme mujore të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit, të cilat më pas paraqiten në dekanat dhe dekanati më pas i përcjell në Rektorat dhe Senat, në nivel njësie kryesore, NJSBC, është përgjegjëse dhe e ka zhvilluar mirë</p>

<p>ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>përgjegjësinë e saj institucionale. Struktura e NJSBC-së, në UST tregon gjithëpërfshirjen e instancave përkatëse për sigurimin e cilësisë. Po kështu edhe Grupi i Vlerësimit të brendshëm, konkretisht (GVB) së bashku me koordinatorët e programeve kanë arritur rezultate bindëse me punën e tyre të përgjegjshme.</p> <p><i>Ref.8.1.Rregullore e Sigurimit të Cilësisë (Kreu tre, neni 19, 20)</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ,bazuar te RVB, dhe vizitën në institucion konstatoi që bazuar në Manualin e NJCBS-së dhe sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC), janë përcaktuar detyra konkrete për gjithë hallkat përgjegjëse të UST-së si:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Senatin e UST-së; -Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë; -Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC); -Koordinatori Institucional pranë ASCAL/(KIAL); -Sektori i Kurrikulës; <p>Në nivel njësie kryesore, NJSBC, është përgjegjëse dhe e ka zhvilluar mirë përgjegjësinë e saj institucionale. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, UST ka krijuar grupet e punës për mbarëvajtjen në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve. Në raportet e vlerësimit akademik GVJ nuk vuri re ndonjë pabarazi apo diskriminim të stafit akademik, ndihmës akademik apo të studentëve.</p> <p><i>Ref.8.1.Rregullore e Sigurimit të Cilësisë (Kreu tre, neni 16)</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e</p>	<p>Qëllimi i NJSBC është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. NJSBC funksionon me bazë Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë; legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloreve të brendshme të UST dhe Statutit të UST. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo edhe e bashkëpunëtorëve të jashtëm, të cilët kanë lidhje me programin e studimit, janë shprehur me idetë, mendësitë dhe përvojën e tyre, për ta bërë programin e studimit më të suksesshëm.</p>

Guoto

[Signature]

mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<i>Ref.8.1 Rregullore e Sigurimit të Cilësisë (Kreu katër, neni 24, neni26)</i> <i>Ligji i IAL-së (Neni 104, pika 5 dhe pika 6)</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, si dhe të marrë gjatë vizitës në UST, GVJ konstaton se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen Web të tij, të të gjitha veprimtarive (statute, rregullore) përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti.</p> <p>Informacioni në nivel njësie bazë përcillet nga NJSBC, ndërkohë që njësia bazë organizon analizën e punës vjetore të departamentit, që bazohet në raportin e NJSBC-së dhe përpunimin e formularëve të vetëvlerësimit të personelit akademik. Studentët informohen përmes njësisë bazë për problematikat që mund të shfaqen në lidhje me cilësinë.</p> <p><i>Ref. 8. NJSBC, "Manuali i NJSBC-së"(Pjesa e IV, neni 5,standardi 8.)</i></p> <p><i>Ref.8.1.Rregullore e Sigurimit të Cilësisë (Kreu Dy, neni 5)</i></p> <p><i>Ref.2.1. Plani Strategjik i UST-së (Prioriteti Strategjik 6, Sigurimi i Cilësisë)</i></p>

Boto

[Signature]

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen ueb të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti. GVJ konsultoi faqen ueb të Institucionit dhe konstatoi se publikimet aktuale në lidhje me rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Rezultatet që dalin nga përpunimi i pyetësorëve nga NJSBC ju dërgohen individualisht secilit personel akademik, si dhe përgjegjësit të njësisë bazë. Njësia bazë bën analizën e punës vjetore të departamentit duke përcaktuar dhe objektivat për të ardhmen. Analizë e punës vjetore bëhet edhe në nivel njësie kryesore, duke përcaktuar objektivat për njësinë kryesore, njësitë bazë si edhe programet respektive që ofrohen.</p> <p><i>Ref.8.1.Rregullore e Sigurimit të Cilësisë (Kreu katër,neni 27)</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se UST, mbështetur në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi,(Manuali i NJSBC-Së), ka vënë në shërbim të studentëve, të Programit të Studimit në Master i Shkencave në "Edukim Fizik e Shëndetësor",rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit,mbështetur paraprakisht nga një punë përgatitore institucionale, në formën e një plani përgatitor masash, ku krahas arritjeve të merituar, vihen në dukje me transparencë, edhe dobësitë dhe mangësitë, të cilat njihen për tu përmirësuar dhe për tu korrigjuar në të ardhmen.</p> <p><i>Ref.8.3. NJSBC (Raporti Vjetor I NJSBC-së).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UST, mbështetur në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi,(Manuali i NJSBC-Së dhe Raporti Vjetor I Punës), ka monitoruar me instrumente institucionale veprimtarinë dhe efektivitetin e realizimit dhe të suksesit të Programit të Studimit në Master i Shkencave në "Edukim Fizik dhe Shëndetësor", me synimin që ta zhvillojë atë drejt progresit në rritje.</p> <p><i>Ref.8.3. NJSBC (Raporti Vjetor I NJSBC-së).</i> <i>Ref.8. NJSBC "Manuali I NJSBC-së" Pjesa e Dytë,neni 6.)</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UST, në mënyrë periodike, vjetore apo semestrale, organizon veprimtarin informuese si për studentët ashtu edhe për personelin akademik në kuadër të rritjes së cilësisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, përmirësimin të programit të studimit, përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe në tërësi për të gjitha shërbimet e ofruara nga UST.</p> <p>UST, bazuar në Manualin e NJSBC-së, në rregulloren e sigurimit të cilësisë dhe materialin përmbajtësor të përfituar nga pyetësorët, ka zhvilluar periodikisht, në bazë të një plani masash, me stafin pedagogjik dhe grupin studentorë, veprimtari informimi, por edhe ndërgjegjësim, me qëllimin e vetëm, përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>Ref.8.NJSBC“Manuali I NJSBC-së”Pjesa e Dytë, neni 5. standardi 9.</i></p> <p><i>Ref.8.1. Rregullore e Sigurimit të Cilësisë (Kreu III, neni 16)</i></p>
---	--

<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie bazë, Rregulloren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Auto



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në:
“Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor”**

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Drejtimi dhe Administrimi i programit i Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes shihet të jetë vizionar. Nëpërmjet rregulloreve, raporteve vjetore dhe punës për kërkimin shkencor pedagogët e këtij fakulteti përmbushin realizimin e këtij standardi;
2. Kërkimi shkencor në nivel universiteti ka ardhur duke u rritur. Në vitin e fundit është krijuar Drejtoria e Kërkimit Shkencor që synon të shpalosë nëpërmjet punimeve të universitetit ide dhe vizione të reja në funksion të rritjes së cilësisë së punës me studentët e UST;
3. Tabela analitike e pedagogëve të UST, dhe veçanërisht të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes flasin për një nivel të lartë akademik në fushën e mësimit dhe nxënies në nivelin e masterit shkencor mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor”;
4. Infrastruktura e universitetit shihet të jetë pasuruar me mjedise dhe pajisje moderne në disa drejtime;
5. Funksionon me një matje të rregullt institucioni i NjSBC që zhvillon përmes aktivitetit të vazhdueshëm ruajtjen e sigurisë së Brendshme të cilësisë;
6. Është për t'u vlerësuar politika e ndërkombëtarizimit e institucionit në marrëveshjet e shumta me partnerë të huaj jashtë vendit dhe renditja si e barabartë e UST në nivel evropian dhe më gjerë;

b. Pika të dobëta:

1. Pavarësisht hartimit të kurrikulës jo më larg se 3 vite më parë në udhëheqjen e grupit të MAS, kurrikula e Masterit Shkencor karakterizohet ende nga paqartësia e saj në lëndët e saj në fushën e pedagogji-psikologjisë. Mungojnë në përgatitjen e mësuesve të ardhshëm lëndë si Psikologjia e Edukimit apo Legjislacioni arsimor; (*Standardi II.1, kriteri 1 dhe 5*)
2. Biblioteka është mjaft e varfër me literaturë pedagogjike dhe psikologjike. Fondi i ulët me rreth 134 tituj nuk mundëson diskutimin e lëmit të mësuesisë në diskutime apo seminare në masterin e mësuesisë; (*Standardi II. 4, kriteri 5 dhe Standardi IV.3 kriteri 3*)
3. Ndryshe nga shumë universitete të tjera shihet se në UST ka mungesë aktivitetesh rinore dhe grupimesh të organizuara në klube dhe shoqata brenda institucionit. Motivimi i këtij organizimi duhet të kapërcejë vetëm fushën e sporteve ; ai duhet të shkojë përtej për t'i përgatitur studentët për një jetë më intelektuale se deri tani në kohën e lirë; (*Standardi V.5 kriteri 3*)

Rekomandime

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


113

1. Rishikimi i Programit (Kurrikula në funksion të përgatitjes së mësuesve të Edukimit Fizik dhe Shëndetësor) Rekomandohet një rishikim i programit për ta përmirësuar dhe pasuruar atë në dobi të mësuesve cilësorë të së ardhmes me lëndë si Psikologjia e Edukimit apo Njohuri për legjislacionin e Arsimit. Për arritjen e këtij qëllimi do kërkohej që mësuesve të ardhshëm t'u jepeshin më shumë njohuri dhe aftësi zbatuese në lidhje me Psikologjinë e Edukimit dhe Legjislacionin arsimor pasi kurrikula aktuale nuk parashikon lëndë ose module në lidhje me to;
2. Rekomandohet që UST të parashikojë rritjen e buxhetit në "Fondin bazë për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë shkencore", "për kërkimin shkencor bazë", "për veprimtaritë shkencore" si edhe "për botime me faktor impakti" në funksion të Programit të Studimit Master i shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor , program ky i ri që kërkon mbështetje më të fortë se programet e tjera;
3. Në vizitën e bërë në bibliotekë u konstatua se në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në " Mësuesi në Edukim fizik e Shëndetësor" në lëmin e mësuesisë fondi është i ulët, vetëm 134 tituj. Rekomandojmë që të punohet më shumë në pasurimin e bibliotekës së UST në fushën e pedagogji-psikologjisë në veçanti dhe të mësuesisë në përgjithësi. Ky numër duhet të vijë duke u rritur;
4. Rekomandohet rritja e buxhetit të UST në funksion të pajisjeve kompjuterike të reja, duke bërë zëvendësimin e nevojshëm të pajisjeve të vjetra dhe jofunksionale;
5. Rekomandohet që të punohet më shumë për organizimin e studentëve në klube dhe shoqata studentore ku ata të mund të ndajnë në mënyrë intelektuale kohën e lirë të tyre;
6. Rekomandohet që të zhvillohen analiza dhe mësimet të hapura në bazë të përvojave që lektorët e Departamentit fitojnë në vizitat apo bashkëpunimet e tyre me kolegët dhe universitetet e huaja me të cilat kanë bashkëpunime;

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science "Teacher in Physical and Health Education"

a. Strengths and Affirmations:

1. The direction and administration of the Faculty of Movement Sciences program is seen to be visionary. Through regulations, annual reports and work for scientific research, the lecturers of this faculty fulfil the realization of this standard;
2. Scientific research at the university level has been increasing. In the last year, the Directorate of Scientific Research was created, which aims to develop new ideas and visions through the works of the university in order to increase the quality of work with UST students;

3. The analytical table of the lecturers of UST, and especially of the Faculty of Movement Sciences, speak of a high academic level in the field of teaching and learning at the level of the master of science: the teacher in Physical and Health Education";
4. The infrastructure of the university is seen to have been enriched with modern facilities and equipment in several directions;
5. The institution of NjsBC functions with a regular measurement that develops through continuous activity the preservation of internal quality security;
6. It is worth evaluating the internationalization policy of the institution in the many agreements with foreign partners abroad and the ranking of UST as equal at the European level and beyond;

b. Weak points:


1. Despite the drafting of the curriculum no more than 3 years ago under the leadership of the MAS group, the curriculum of the Scientific Master is still characterized by its ambiguity in its subjects in the field of pedagogy-psychology. Subjects such as Educational Psychology or Educational Legislation are missing in the preparation of future teachers; (*Standardi II.1, Criterions 1 dhe 5*)
2. The library is quite poor with pedagogical and psychological literature. The low fund with about 134 titles does not allow the discussion of the field of teaching in seminars in the master of teaching; (*Standardi II. 4, Criterion 5 dhe Standardi IV.3 Criterion 3*)
3. Unlike many other universities, it can be seen that in UST there is a lack of youth activities and groups organized in clubs and associations within the institution. The motivation of this organization should go beyond the field of sports; it must go beyond to prepare students for a more intellectual life than till now in their free time; (*Standardi V.5 Criterion 3*)

Recommendations

1. Review of the Program (Curriculum in function of the preparation of Physical and Health Education teachers) a review of the program is recommended to improve and enrich it for the benefit of future quality teachers with subjects such as Educational Psychology or Knowledge of Education legislation. . To achieve this goal, it would be required that future teachers be given more knowledge and practical skills related to Educational Psychology and Educational Legislation, since the current curriculum does not provide courses or modules related to them;
2. It is recommended that UST foresee the increase of the budget in the "Basic Fund for scientific research and scientific activities", "for basic scientific research", "for scientific activities" as well as "for publications with an impact factor" in function of the Master Study Program of Sciences in "Teacher in Physical and Health Education, this new program that requires stronger support than other programs;




3. In the visit to the library, it was found that in the function of the Master of Science study program in "Teacher in Physical and Health Education" in the field of teaching, the fund is low, only 134 titles. We recommend that more work be done to enrich the UST library in the field of pedagogy-psychology in particular and teaching in general. This number should be increasing;
4. It is recommended to increase the budget of UST in function of new computer equipment, making the necessary replacement of old and non-functional equipment;
5. It is recommended to work more on the organization of students in clubs and student associations where they can intellectually share their free time;
6. It is recommended to develop open analyzes and lessons based on the experiences that the lecturers of the Department gain in their visits or collaborations with colleagues and foreign universities with which they have collaborations;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Bueto

